

Luan  
Oafëzezi

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

814-2  
216

MESIM  
NGA HISTORIA

DRAME


814-2  
—  
216

LUAN QAFËZEZI

Kjo është një vëllim i lindur nën poshten e një  
familje shqiptare. Ai është një vëllim i lindur nën  
poshten e një familje shqiptare. Ai është një vëllim i lindur nën poshten e një  
familje shqiptare.

# MËSIM NGA HISTORIA

dramë



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

LOVËR D'ARTIST

Kjo dramë fitoi çmimin e dytë në konkursin për drama  
dhe skenarë, shpallur për ndër të 35-vjetorit të themelimit të  
Partisë.

# MESIM NGA HISTORIA

SHTRIJE

«THE HISTORY OF THE MAMMALS»

## PERSONAZHET

METUSH META	- Sekretar i organizatës së partisë	vjeç	28
MEHMET DELIA	- Komunist, komandant i njësitit guerril	»	40
ÇELIK ZANA	- Komunist, anëtar i njësitit guerril	»	20
KARADAKU	- Komunist, anëtar i njësitit guerril	»	30
TAFILI	- Komunist, anëtar i njësitit guerril	»	22
ASIM ZAGORA	- Zëvendëskomandant i njësitit guerril, anëtar i grupit edukativ të partisë, mësues	»	27
MËRKURI	- Komunist, përgjegjës i teknikës së partisë	»	26
BESA	- Komuniste, anëtarë e njësitit guerril	»	19
IRENA	- Komuniste, e fejuara e Asimit, mësuese	»	23
VASO GJIKA	- I ri komunist, djalë i tetë Katinës	»	16
TETO KATINA	- Shtëpiake, aktiviste e Lëvizjes	»	55
THANAS VERRIA	- Froletar e komunist veteran	»	60
SOKRAT ISAU	- Mësues, pensionist	»	60
PUNËTORI ROJE	- Një nga krerët e ish-Grupit Komunist të «Të Rinjve» (Miop. Mban gjyslykë)	»	45
DIDAR OSMANI	- Avokat, përgjegjës i celulës së ish-Grupit Komunist të «Të Rinjve» në Kuçovë	»	34
KOLË DOLLANAJ	- Profesor i kursit «Dante Aligieri», anëtar i celulës së ish-Grupit Komunist të «Të Rinjve»	»	27
MILO SHULLERI	- Jurist i Shoqërisë AIPA, anëtar i celulës së ish Grupit Komunist të «Të Rinjve»	»	28
DEMIR GONGU			26

TENO GORENI	- Punëtor në naftë	» 44
GJERGJ GOLEMI	- Punëtor në naftë	» 26
LAZE GJINAJ	- Kreu i zjarristëve në Kuçovë, inxhinier	» 42
ESMA ZAGORA	- Nëna e Asimit	» 64
ANXHELO ANDREOTI	- Kapiten i kuesturës	» 30
GABRIELI	- Marshall i kuesturës	» 38
UGOLINI FOSKOLO	- Rreshter i kuesturës	» 32
MENTOR DAKAJ	- I përjashtuar nga partia, gjeometër	» 26
NJË QYTETAR PLAK		

**Prolog**

*Në paraskenë*

## *Në paraskenë*

**THANAS VERRIA** – Jam një nga komunistët e mot-shëm. Dëshiroj t'ju kujtoj një ngjarje jo fort të largët. Di-sa nga ju e kanë jetuar. Të tjerët ende s'kishin lindur në ato ditë. Megjithatë le të mësojmë nga ajo që i ngjau Asim Zagorës, një shokut tonë të armëve që kaloi nëpër një rrugë të vështirë. Them kështu, sepse në botë sot ka mjaft pinjollë të Bernshtajnit, Kautckit e Trockit, tradhtarë e demagogë të gjithfarë flamujve, si Anastas Lulot e Sadik Premtet. Të tillë, siç ka treguar e po tregon historia, s'kanë munguar e s'do të mungojnë të derdhin hel-min e tyre në radhët e proletariatit botëror, gjersa mbi rruzull të ketë truste e uollstritë, imperialistë e vende ku janë në fuqi revizionistët.

Sidoqoftë, duke menduar se ky mësim do të na vlejë, le t'ia lemë fjalën Asimit dhe atyre që bashkë me të morën pjesë në ato ngjarje e në ato ditë... Mirupafshim!

(Del. *Hapet sipari*.)

## PJESA E PARË

Veprimet zhvillohen në qytetin e dikurshëm të Kuçovës. Skena në shtëpinë e Kol Kollanajt. Dhomë e pritjes. Dhomë e mobiluar mirë, si shtëpi të pasuri.

**KOLA** — Shokë, kemi fatin e mirë të kemi për herë të parë midis nesh, në këtë qendër të madhe punëtorësh, një nga krerët e Grupit Komunist të «Të Rinjve», shokun Didar Osmani. Njihuni! (Të gjithë duke i dhënë dorën)

**MILOJA** — Shullëri.

**DEMIRI** — Gongu.

**KOLA** — (Në rolin e shpjeguesit, shtrin dorën nga Miloja.) Profesor i kursit «Dante Aligieri» këtu, (Duke u kthyer nga Demiri.) jurist i shoqërisë AIPA.

**DIDARI** — (I përzemërt e buzagaz.) Gëzohem shumë, shoku Shullëri e shoku Gongu. Kam dëgjuar shpesh për ju.

**LAZJA** — Inxhinier Gjinaj.

**DIDARI** — (Mendohet për t'u kujtuar.) Inxhinier Gjinaj? Gëzohem gjithashtu! (Ia shtrëngon dorën me të dy duart. Teno Goren, pa thënë emërin i shtrin dorën me përtesë.)

**DIDARI** — Po ju, si quheni?

**TENOJA** — (Ftohtë.) Teno Goren, punëtor rröte në sektorin e Kozarës.

**KOLA** — Po. Shokun Goren e kemi me origjinë punëtore.

**DIDARI** — Emrat e të tjerëve më janë të njojur që të gjithë nga raportet e vazhdueshëm të shokut Kolë, kurse emrin tuaj (i drejtohet Lazes) s'kujtohem ta kemi dëgjuar tjetër herë! Falmëni! Ndoshta kujtesa ime e dobët....

**KOLA** — Jo. Është hera e parë që e dëgjoni. Vjen nga radhët e Grupit Komunist të «Zjarrit». Ka qenë përgje gjës i bërthamës së tyre në këtë qytet. Pas hedhjes së të tjerëve në radhët e Partisë, i mbetur pa shokë, u bashkua me ne dhe, tanë, është ndër më aktivët midis tanëve.

**DIDARI** — Ashtu? Edhe njëherë duke ju shprehur konsideratën time, gëzohem, shoku Gjinaj.

**LAZJA** — Unë edhe më fort që m'u dha rasti t'ju njoh personalisht.

**KOLA** — Tani në emrin tuaj fjalën po ia jap shokut Didar.

**DIDARI** — Shokë! Siç e shikoni s'është kohë fjalimesh. Po hy drejt e në temë. Mblidhemi në një çast kur gjendja në Vlorë është elektrizuar e tëra. Siç na informon shoku Sadik Premte, Çeta Plakë e Vlorës është vënë tërësisht nën urdhrat e tij. Pozitat e Komitetit Qarkor ekzistues të Partisë janë lëkundur plotësisht. Kështu, në këto rrëthana, nën drejtimin e tij, janë preqatitur kushtet për zgjedhjen e komitetit qarkor të ri, ku në krye të tij, pa dyshim, ka për të dalë ai vetë.

**LAZJA** — E habitshme!

**DEMIRI** — S'ka gjë për t'u habitur. Një njeri si ai, me sa e njoh unë, çdo majë mund ta arrijë.

**DIDARI** — Ashtu është, shoku Gongu. Ndërkohë, nën drejtimin e Sadikut, është arritur një marrëveshje me disa nga krerët e Qarkorit të Gjirokastrës, të cilët po veprojnë me shpejtësi për arritjen e këtij objektivi të përbashkët. Gjithashtu, me anë letrash, jemi vënë në lidhje edhe me shumë kuadro të tjera të rëndësishme në qarqe, e sidomos në Tiranë, ku janë shumica e tanëve. Pra, siç e shihni, është marrë çdo masë. Fitorja në tre qarqet kryesore të jugut: Vlorë, Gjirokastër, Berat, do të ndikojë edhe mbi qarkun e katërt e të fundit: Korçën, e po ashtu edhe mbi vetë Tiranën e qarqet e tjerë të vendit.

**LAZJA** — Quajeni si të doni, por unë prapë them: e habitshme, shokë!

**DEMIRI** — Vazhdoni, shoku Didar, vazhdoni.

**MILOJA** — Vazhdoni, vazhdoni! Na entuziazmuat, shoku Osman!

**DIDARI** — Pra, kjo është situata. Dhe unë them me bindje se pavarësisht nga disa suksese të bujshme të Partisë Komuniste të sotme dhe pavarësisht që gjatë kësaj periudhe ajo ka fituar mjافت teren, prapëseprapë, Parti Komuniste këtu ka për të mbetur vetëm grupi ynë komunist (*I bie me grusht tavolinës për t'i dhënë më efekt fjalës. Rregullon gjyslykët.*)

**KOLA** — (*Duke mbushur e duke i afruar gotën me ujë.*) Po të ndiesh nevojë...  
KOLA — (*Duke mbushur e duke i afruar gotën me ujë.*) Po të ndiesh nevojë...  
**DIDARI** — Falemnderit. (*E largon gotën.*) Me sa thashë më lart, ndokush mund të pyesë: «Po ç'na ndan ne si komunistë nga Partia Komuniste e sotme? Pse ne s'e aprovojmë vijën e saj?» Po si mund t'i thuash vetes komunist, kur për revolucionin proletar, proletariatin e diktaturën e tij nuk flet asnje fjalë? Kur harron se tek e fundit qëndrimi i përkohshëm i italianëve në Shqipëri, po ta shikosh çështjen me syrin e klasës dhe jo me syrin e një nacionalisti borgjez, është plotësisht në dobinë tonë nationale ose klasore? Kur harron se investimet e kapitalit të madh italian do të ndihmojnë në ngritjen dhe rritjen e shpejtë të industrisë tek ne e, si rrjedhim, edhe në formimin e zgjerimin e klasës sonë punëtore? Po a mund të mbahet një Parti Komuniste pa kolonën e saj vertebrale? Pa klasën? Pa kuadro të mjafta e të pregititura?

**LAZZA** — Këto kanë qenë edhe vërejtjet e ish-Gru-pit Komunist të «Zjarrit», shoku Didar. Dhe pikërisht këto na kanë bërë që të flasim me aq zemërim e urrejtje për ta.

**DIDARI** — Dakord, shoku Gjinaj. Po gjynahet e tyre shkojnë edhe më larg. Krerët e Partisë Komuniste të sotme arrijnë gjer në atë shkallë sa në postet drejtuese të luftës të kenë edhe borgjezë e, ngandonjëherë edhe klerikë mijekërgjatë.

**LAZZA** — *Parolë d'onër,\*)* një komedi e vërtetë!

**DIDARI** — Dhe krahasoni tanë qëndrimin e tyre me qëndrimin e klasikëve të marksizmit ndaj borgjezisë e po ashtu ndaj fesë, e cila, siç dihet, s'është gjë tjetër vecse

\* Për fjalë të nderit.

opium e hashash për popullin e proletariatin e shfrytëzuar. Besoj, shokë, këto argumente s'kanë nevojë për asnje koment.

**MILOJA** — E drejtë, e drejtë... E qartë edhe për fëmijët.

**DIDARI** — Këto qenë edhe arsyet që shokët Anastas Lula dhe Sadik Premte s'e përkrahën shkrirjen e grupeve komuniste dhe ngritjen e një Partie të tillë në nëntorin e 41-së. Siç e thekson Sadiku, ajo u ngrit kundër vullnetit tonë. Dhe pikërisht kjo rezervë bëri që një pjesë të kuadrove e të celulave, siç është dhe kjo e juaja këtu, të mos ia dorëzonim partisë së posaformuar. Dhe besoj se taktkisht për atë kohë ky veprim yni ishte krejt i drejtë. Ashtu sikurse me ndërrimin e kushteve mbetja jashtë saj do të ishte e dëmshme lidhur me çështjen tonë. Pra, marrja e timonit tani, kur ajo është forcuar e zgjeruar, mund të bëhet vetëm duke qenë brenda radhëve të saj. Veçse kjo punë kërkon guxim e urtësi, duke vepruar me shumë kujdes sipas direktivave strikte të qendrës së grupit tonë komunist. Kjo qe edhe arsyaja që, me udhëzimin tonë përtë fituar kredi e besim në masa e në parti, ju morët pjesë në demonstratën që u zhvillua sot.

**LAZJA** — Ndoshta s'ju kuptova mirë. Ju thatë: mbetja jashtë saj, pra jashtë radhëve të Partisë së tyre, do të ishte e dëmshme për çështjen tonë. Mos deshët të thoshit të shkrihem i në Partinë e tyre, shoku Osman?

**DIDARI** — Mos u shqetësoni, shoku Gjinaj! Në luftë ka strategji dhe taktkë. Dhe këtu s'kemi ndryshim strategje, po manovrim takтик për të arritur fitoren me sa më pak sakrifica e gjak shokësh.

**MILOJA** — Tamam ashtu.

**KOLA** — Shoku Gjinaj! Anastasi e Sadiku i kanë menduar e peshuar të gjitha.

**DIDARI** — Dhe ju hapin e parë e bëtë sot me pjesë-marrjen në këtë demonstratë. Atë e organizoi Partia, po flamurin e saj, në të vërtetë, e morët ju, me fjalimin që mbajtët, në mbrojtje të të arrestuarve politikë që kërkojnë të internojnë. Kjo, me siguri, i ka vënë përpara një të papriture Metush Metët. Të gjetur ngushtë, unë shpresoj

se kur t'u drejtoni kërkeshën, do t'ju pranojnë, po edhe në refuzofshin, duke nxjerrë ndonjë pretekst, ne, me anën e shokut Anastas, që prej kohësh vepron në qarkun e Beratit, jemi pregetitur edhe pér një rrugë të dytë...

LAZJA — Në ç'mënyrë e cilën rrugë?

DIDARI — S'është rasti pér hollësira e shpjegime, shoku Gjinaj. Sidoqoftë, Kola do të vihet në dijeni pér të gjitha.

KOLA — (Serioz) E qartë.

DIDARI — Mirë. Përsa i përket hollësirave të tjera, ato do t'i merrni në një mbledhje tuajën të veçantë. Tani, a ka ndonjë shok që do të pyesë, o ndonjë tjetër që kërkon të flasë?

KOLA — Të gjitha sa the, qenë të qarta. Veç nuk, e kuptoj pse shoku Gorenin nuk foli në këtë mbledhje asnjë fjalë?

TENOJA — Unë nuk e kuptoj, pse më kini thirrur në këtë mbledhje, Kolë?

KOLA — Si anëtar i celulës sonë.

TENOJA — Unë kam afro dy muaj që s'u jam përgjigjur thirrjeve tuaja.

KOLA — Atëherë, mos ndoshta vallë, je duke iu përgjigjur thirrjeve të ndokujt tjetër? Sipas një të dhëne, thuhet se kohët e fundit diku je takuar një herë me Metush Metën. Pér ballafaqim këtu, është edhe shoku Gjinaj, të cilil s'ke mundur t'ia mohosh plotësisht këtë të vërtetë. Fol hapët! Shokët e presin këtë përgjigje shqetësuese nga ti. Ka ardhur koha të ndahet shapi nga sheqeri!

TENOJA — S'është e vërtetë se unë jam takuar një herë me komunistin Metush Meta! Laze Gjinaj s'ju ka thënë të vërtetën!

LAZJA — Gënjen! Gënjen! I gjetur ngushtë ti u dettyrove të ma pohoje plot gojën takimin me të!!

TENOJA — Po. Por jo që jam takuar vetëm një herë... Po disa herë gjatë këtyre dy muajve. Dhe pér çdo herë...

KOLA — Sii? (E shikon rëndë e me kanosje. Heshtje e gjatë.).

TENOJA — Përse më shikon ashtu? Thashë të vër-

tetën. Dhe i falemnderit shumë Metush Metës. Ai ka kohë që përpiquej për të m'i hapur sytë, por unë, në të vërtetë, sonte u binda plotësisht për të gjitha ato që kam dëgjuar prej tij...

*KOLA — (I nervozuar ndez cigaren dhe e vendos në pipë.)* Atëhere çështja s'qenka e thjeshtë...

*DIDARI — S'ju vjen zor nga vetja kur thoni: «Ai më hapi sytë?»*

*LAZJA — Parolë d'onër, një nulitet e njeri pa kulturnë që gjithkush nga ne do ta kishte bezdi të këmbente qoftë edhe dy fjalë të vetme me një njeri të atillë!*

*TENOJA — Ju po, kurse unë, jo, Laze Gjinaj. Ai përmasat në këtë qytet éshtë përfaqësuesi i Partisë. Pra, i së vetmes Parti Komuniste në vendin tonë.*

*DIDARI — (Me ironi.) I së vetmes? (Cinik) Ha, ha, ha!*

*TENOJA — Po, po. I asaj që i nxori bojën e ia bëri brinjët copë Grupit trockist të «Zjarrit» si dhe elementit grupazh nga ish-grupi ynë. Megjithëkëtë, qeshke bukur! Po mos harro se pas zbardhjes së dhëmbëve vjen zbardhja e syve, Didar Osmani. «Ndjesë pastë» s'di pse po më kujtohet në këto çaste Mikel Malushi. Kështu dikur zbardhët dhëmbët dhe ai. Pastaj, i ndjeri, zbardhi sytë...*

*DIDARI — Si, siii?! (Heq e vë gjyslykët me shqetësim.)*

*KOLA — Frenoje atë gjuhë, se për ndryshe!...*

*LAZJA — S'ka nevojë për nxehje! Veçse ja ku dole në shteg, Teno Goreni. Pra, një parti që e quan veten komuniste e që vret komunistët, siç vrau shokun tonë të paharruar, zjarristin e komunistin Mikel Malushi.*

*TENOJA — Jo komunistin Mikel Malushi, po spiunin e fashizmit Mikel Malushin, që mundi të gjente strehë vetëm në një strofkë si e jona...*

*LAZJA — Ja rruga e Partisë së Metush Metëve. E huaj për komunizmin fund e krye. Dhe jo vetëm në një drejtim, po në shumë drejtime bashkë.*

*TENOJA — Po a mund të m'i konkretizosh këto drejtime?*

*KOLA — T'i konkretizoj unë, megjithëse, për mjaft çështje, ne kemi pikëpamje të kundërta me ato të Grupit*

të «Zjarrit». Sipas nesh, një vijë që kalon nga utopia gjer në aventurë. Dhe utopia nis që nga akti i shkrirjes së grupave dhe kalimi prej tyre në formimin e një Partie të vetme Komuniste në një vend ku s'ka industri, ku s'ka proletariat. Ku shpresat për luftë e revolucion, pra për fitore, kjo Parti i mbështet te nacionalistët borgjezë e te një fshatarësi injorante e konservatorë jashtë çdo mase. Pra, me sa përmenda më lart, Teno Gorenji, a s'është diçka formale formimi i një Partie të tillë kur ajo, në kushtet konkrete të vendit, s'ka asnë mundësi të bëhet udhëheqëse e masave të gjera të fshatit e qytetit e të drejtøjë luftën e tyre për çlirim nacional? Ja, kjo është utopia sipas pikëpamjes sonë. Kurse përrugën adventureske të saj, mjafton të përmendja këtu hedhjen e hapët të shokëve në propagandë e aksione kompromentuese kundër një fuqie të madhe, siç është fashizmi italian. Kuptohet, kjo i likuidon kuadrot...

**TENOJA** — The se ndahemi me Grupin e «Zjarrit» në mjaft çështje e pikëpamje, po në të vërtetë është i njëjtë qëndrim dhe e njëjta gjuhë. Qëndrimi i deviatorëve dhe gjuha e kolonës së pestë. Dhe s'ka si të jetë ndryshe. Rruga e përbashkët krijon edhe gjuhë të përbashkët.

**KOLA** — Para se t'i nxjerrësh, do të bëje mirë t'i pëshoje fjalët, se ndryshe mund të të kushtonin shtrenjtë!

**TENOJA** — Të erdhi hidhur si duket. Po ndërsa ne llomotisim këtu, ata po ngrejnë Shqipërinë në këmbë... Fshat edhe qytet.

**DIDARI** — Në ato suksese, nëse mund t'i quajmë kështu, ti e di mirë, kanë pjesë edhe tanët.

**KOLA** — ...Dhe s'është çudi që nesër edhe celula jonë këtu, e të tjera si kjo gjetiu, për arsyet që dëgjove, të radhiten në atë front lufte për të marrë në duar timonin e për ta kthyer në rrugën e klasës Partinë.

**TENOJA** — Votën time, për t'u pranuar në ato radhë, ja ku po jua them ndër sy, do ta keni kundër, Kolë Dollanaj. Po as Metush Meta me shokët e tij s'besoj të pranojnë në radhët e tyre njerëz si ti e shokët e tu, nga c'dëgjova sonte në këtë mbledhje. Ajo s'është Parti e deviatorëve, po e komunistëve dhe e luftëtarëve. Jo kënetë, po det në

stuhi. E kur deti bën stuhi, fundërinat gjithnjë i nxjerr jashtë. Ky është edhe ligji i revolucionit. Dhe Anastasi e Sadiku e dinë mirë se ç'përgjigje u ka dhënë Partia atyre.

*DEMIRI* — Sa turp! Flet kështu kundër atyre që të kanë hapur sytë?

*LAZJA* — Po as më thua, kush, gjer më sot, nga Partitë Komuniste ka denjuar ta njohë këtë parti, Teno Goren? A mund të m'i përgjigjesh kësaj pyetjeje? (*Në themës ndihen krisma pushkësh.*)

*TENOJA* — Po. Ja përgjigjja! Atë e njeh Shqipëria! E njeh populli shqiptar, që është ngritur i téri në këmbë e po lufton nën udhëheqjen e saj, kurse mua më vjen ndot tek mendoj se kush po ma bën këtë pyetje!

*KOLA* — Shiko! Freno gjuhën, Teno Goren! (*Nga nervozizmi dhe tronditja e heq dhe e vë shpesh pipën në gojë. Prapë ndihen pushkë. Shpejton drejt dritares përtë parë.*)

*TENOJA* — Dëgjojini, dëgjojini në keni veshë! Ata luftojnë, kurse ne po strukemi rrëzave si minjtë.

*KOLA* — Si?! Gjer këtu arriti urrejtja jote ndaj nesh?

*TENOJA* — Po. Ky është sqarimi e mësimi që më ka dhënë Metush Meta në këta dy muaj. Flas në emër të komunistit e proletarit të mashtruar. Të atij që, pa dashtur, ka mashtruar edhe të tjerët. Veç një gjë të dish: Të gjithë ata që e kanë braktisur këtë strofkë të ndyrë, ta njohin fort mirë lëkurën, me përjashtim të Asim Zagorës, që me naivitetin e tij fëmijnor, megjithëse u shkëput prej kohësh nga ju, akoma kujton se ti je viktima e kërëve të mbajgrupit, viktima e një urdhri të dhënë nga lart për t'i mbajtur shokët larg luftës e larg Partisë. Tani, në djall të vesh, megjithëkëtë qivur që më ke këtu përkrah, e që s'i ka mbetur gjë tjetër veç frazeologjisë së majtë. (*Tregon me gisht Didarin.*)

*DIDARI* — Ashtu, ë? (*I del përpëra në shenjë kërcënimi.*)

*TENOJA* — Mos m'u kanos në atë mënyrë, se këto duar me kallo që s'i tremben as hekurit... të bëjnë copë! Dhe pate guximin të na dërdëllisje se një kopuk si Sadiku ka

në dorë Vlorën e Gjirokastrën! Një birbo si ti e një kopuk si ai, as mua që më keni këtu brenda nuk më keni ndër duar. Jo pastaj Vlorë e Gjirokastër! Na! (I tregon bërrylin.) Këtë Vlorë e këtë Gjirokastër keni ju!

KOLA — (I ndezur.) I pafytyrë! (Tenton t'i hidhet. Tenoja i heshtur e i patundur i afrohet, e kap për supesh dhe pasi e shkund dhe e tendos mirë me shpatulla për muri, ia heq nga goja pipën që e mban me kapadaillék dhe ia flakërin për tokë. Kola i dërrmuar moralisht, me habi e tronditje:) Sii?! Ky qe fundi, Teno Goreni?

TENOJA — Po! Tani në djall të vini të gjithë bashkë! (Merr të dalë.)

DIDARI — (Bën t'i derdhet. Të gjithë vihen në lëvizje.) Mos e lini, shokë!

TENOJA — (Duke nxjerrë revolverin.) Mos lëvizni! Pérndryshe jua fluturoj kafkat në erë. (Zmbrapset. Del.)

DIDARI — (I tronditur rëndë.) Shokë! Në këto momente, likuidimi i tij në çast është detyra jonë e parë!

LAZJA — Këtë mision besomani mua, shoku Didar!

KOLA — Po, Lazes.

DIDARI — (I alarmuar.) Veçse pa humbur asnjë moment, shoku Gjinaj! Ai s'duhet të mbërrijë në asnjë mënyrë te shokët e vet! Pérndryshe, Sadiku e Anastasi rrezikohen seriozisht.

### Bie perdja

Skenë në shtëpinë e teto Katinës. Dhoma ka një minder anash. Një tavolinë e disa karrige, një shtrat druri, një dollap enësh si dhe një kornizë në xham, ku janë vendosur disa fotografi të familjes. Duket që është shtëpi të varféri. Në skenë: Mehmeti, Tafili dhe Karadaku, këndoja me zë të lehtë këngën e Mine Pezës.

TAFILI — Pas kësaj që ngjau, ma thotë mendja s'do të guxojnë t'i internojnë.

KARADAKU — Vérteq një lumë në vërshim! E sidomos ai vargu i gjatë i nënave. Akoma më duket sikur i dëgjoj thirrjet e tyre: «Larg duart nga djemtë tanë!»

*MEHMETI* — Kur ngrihet populli éshtë e pamundur ta përbash.

*TAFILI* — Nga ne thonë: «Populli éshtë si deti!»

*MEHMETI* — Dhe ky det i egërsuar, tek i cili mbësh-tet kaq fort Partia, do ta përpjë këtë gjemi piratësh, Tafil. (*Ulet në tryezë. Nxjerr nagantën.*) Po që t'ua japim përgjigjen hakçë, (*Tregon nagantën.*) kësaj i duhet bërë hyzmeti gjer në fund. (*Fillon ta pastrojë.*)

*TAFILI* — Atë punë bëra edhe unë pak më parë. Kur-se tani, të kisha një cigare!

*KARADAKU* — (*I hequr mënjanë, posa éshtë ulur dhe po grin ca fletë duhani.*) Cigare? Ja ku ke sa të duash! Të dredhur e të padredhur, si ta ka ënda. (*I nxjerr kutinë.*)

*TAFILI* — Jo. Do ta dredh vetë për qejf, Karadak! (*Dredh një cigare.*)

*MEHMETI* — Ja edhe për ta ndezur... (*Nxjerr çak-makun*)

*TAFILI* — Mos u mundo. Vlaga e tokës dhe era e esh-kës sikur më përtërijnë, Mehmet! Unë jam fshatar. S'di sa më ka marrë malli për parmandën dhe erën e barit. (*Nxjerr masatin, vë eshkën mbi strall dhe e shkrep. Ndez cigaren, duke nuhatur me èndje erën e eshkës.*)

*MEHMETI* — Të kuptoj... Edhe mua më djeg ai mall.

*TAFILI* — Ta them hapët: sa të mbarojë kjo luftë, pa menjëherë atje do të shkoj.

*KARADAKU* — Po, kur ke kaq mall, pse e le parmen-dën dhe more këtë rrugë?

*TAFILI* — U varfëruam, Karadak. Edhe dy copë ara që patëm, i shitëm. Duke e parë pisk, babai më nisi për këtu, për të fituar ndonjë lek e për t'i blerë edhe njëherë ato që shitëm. Po për djall s'u bëkan dot dy kacidhe bashkë!

*MEHMETI* — (*Qesh.*) Ha! ha-ha! Si ore, si? Komunist dhe mendon ta blesh tokën me para?

*TAFILI* — Po me se tjetër?

*MEHMETI* — Ja, me këtë! (*I tregon nagantën.*) Kur të fitojmë luftën, Partia menjëherë do t'ua japë tokën falas fshatarëve që e punojnë.

**TAFILI** — Tallesh!

**MEHMETI** — Aspak! Pse, s'e ke ditur këtë?

**TAFILI** — More, ma tha një ditë Çeliku, por unë kujtova se e shpiku nga koka! Breh, breh! Po kjo s'qenka shaka, Mehmet!

**KARADAKU** — Eh, Tafil, Tafil! Veç, që të vijë ajo ditë, duhet të rrjedhë shumë ujë. Po, ujë i kuq, ama!

**MEHMETI** — E, me gjithatë edhe atëherë, ne, si komunistë e ushtarë, prapë do të shkojmë atje ku do të ndihet nёvoja më shumë.

**KARADAKU** — Ja, për shembull unë, po të ishte me dëshirë, përsëri do të dëshiroja të mbetesha këtu. Me sa di, kjo është edhe dëshira e Metushit. Ai ka pasion për naftën. Mendon, në të ardhmen të studjojë për këtë sektor. Zbulimi dhe nxjerrja e naftës, kërkojnë kulturë, — thotë ai. Kurse Asimi èndërron t'i kushtohet poezisë; Irena, si mësuese, fëmijëve...

**MEHMETI** — Ndërsa Besa, nga uria që ka sot, a e merrni me mend se ç'dëshiron të bëhet? (Pauzë) Kuzhiniere! (Qeshin të tre me zë të lartë. Në prag të derës duket teto Katina.)

**TETOJA** — Falmëni! S'e dija që ishit në mbledhje! (Bën të dalë.)

**MEHMETI** — Hajde, teto Katinë, hajde! Tani presim të na kthehen edhe Vasoja me Asimin.

**TETOJA** — Kur e kam me të, s'di pse jam e qetë, more bij.

**KARADAKU** — Ke të drejtë. Mehmeti thotë: atje ku është Asimi, është fitorja.

**MEHMETI** — Ashtu, vërtet.

**TETOJA** — Ashtu, ashtu! Veç t'i rrojë nënë shkretës! (Hap raftin. Merr diçka) Po ju lë... (Del.)

**MEHMETI** — E gjora plakë! Tani shtëpia e saj është bërë krejt jona.

**KARADAKU** — Edhe Vasoja i saj i vogël s'po na ndahet asnjë hap.

**TAFILI** — Asimi e do me kokë.

**MEHMETI** — E cilin nga shokët s'do me kokë Asimi?

**KARADAKU** — Të gjithë. Veçse, ngandonjëherë s'a-

rrin ta përfytyrojë dot ligësinë e pabesinë tek të tjerët.

TAFILI — Mos e ke fjalën për Kolën?

KARADAKU — Po, Tafil!

MEHMETI — Ke hak. Ai e kujton të drejtë e të pastër, ndaj edhe e mbron ashtu.

KARADAKU — Veçse kur arrin ta diktojë të keqen te ndokush, atëherë edhe urrejtjes e goditjes së tij është e vështirë t'i qëndrosh përballë.

MEHMETI — Ashtu është ai. S'njeh rrugë të mesme, Karadak. Po, si luftëtar, ama, e si udhëheqës ushtarak i ka shokët të paktë. Unë shpesh e përfytyroj në ditët e ardhme në krye të ndonjë batalioni partizan.

KARADAKU — Dhe, me sa di unë, ai ka kohë që kërkon të hidhet në mal.

MEHMETI — Po. Unë e Metushi e kemi mbajtur gjer më sot. (*Ndihen hapa.*)

TAFILI — Ja po vjen . . . (*Në pritje. Hyjnë Vasoja dhe Asimi*)

VASOJA — (*Gazmor.*) Vdekje fashizmit, shokë!

ASIMI — Vdekje fashizmit! (*Të dy nderojnë me grusht*)

ZËRA — Liri Popullit! (*Shtrëngojnë duart.*)

MEHMETI — (*Dashamirës.*) E qërove edhe Umberto Sirakuzën, Asim!

ASIMI — Bashkë me këtë trim! (*Tregon Vason*) Po në të vërtetë atë e qëruan mëkatet e tij, Mehmet.

MEHMETI — Gjersa e more përsipër ti, e dija që do të mbaronte. Pra, shokë, një kuestor më pak.

TAFILI — (*Asimit.*) Të lumtë ajo dorë!

KARADAKU — E ajo pushkë t'u bëftë top, Asim! (*Hyn Irena*)

IRENA — Paske ardhur?

ASIMI — (*Duke pohuar me kokë, i buzëqesh.*)

MEHMETI — (*Me përzemërsi*) Eh, Irenë, Irenë! Ti gjithnjë në hal për Asimin tënd e tonin.

IRENA — Jo. (*E zënë ngushtë*) Pooo . . . (*Skuqet.*)

MEHMETI — (*Irenës, buzagaz.*) E pata me shaka. Sidqoftë, vrasja e Umberto Sirakuzës do t'i bëjë grusht armiqtë në këtë kantier. Po, a doli komunikata, që i bën thirr-

je popullit për të qëndruar në gadishmëri, gjersa armiku të heqë dorë nga internimi i tanëve?

IRENA — Shokët në shaptilograf me të po merren, Mehmet! Një pjesë të kopjeve që kishin nxjerrë i paketova sipas qendrave dhe sektorëve. Pjesën tjetër ...

MEHMETI — (Tafilit e Karadakut) Le të kalojmë matanë për të ndihmuar sadopak në paketimin e tyre. (Ua bën me kokë. Dalin që të tre buzagaz. Asimi i ndjek me sy.)

VASOJA — Atëherë duhet të dal edhe unë... Të fejuarve, të paktën, s'duhet t'u biesh në qafë...

IRENA — (Pa të keq) Hë, lapurak, lapurak! Ditke dhe nga këto, ë? (E ndjek, Vasoja qesh me zë të lartë dhe vjen rrotull tavolinës, gjersa i shpëton dhe del. Qesh edhe Asimi.)

ASIMI — (Gazmor) Të iku!

IRENA — Është me të vërtet xhevahir. (Afrohet e i mbështet kryet në sup.)

ASIMI — E di që më do. Po ti duhet të bëhesh e fortë si Besa. Shpesh s'e pret me qetësi fundin e aksioneve kur marr pjesë unë.

IRENA — S'e mohoj. Se e di që je i rrëmbyer. Ndryshe nga të gjithë shokët. Po plumbi...

ASIMI — Ti thua për mua, po të jesh me Besën, më beson, të vë në hall. S'e marr me mend çfarë guximi ka ajo vajzë në aksione. Gjithnjë do ta shohësh para të tjerëve.

IRENA — (Me stimë) Ajo është proletare, Asim!

ASIMI — Ashtu është. Dhe proletarët kanë nevojë sa të zgjohen dhe të bashkohen, pa pastaj, asgjë nuk i mban. A të kujtohen fjalët e internacionales?

IRENA — Si jo!


ASIMI — (Entuziast, nis të këndoja me zë të lehtë. Në këngë e shoqeron dhe Irena.)

«Nga mbreti e zotit s'duam shpëtimin»

IRENA — Ah, kur do të vijë ajo ditë!

ASIMI — Do të vijë, Irenë. Proletariati u zgjua. Popujt s'pranojnë më zgjedhë.

IRENA — Do të më mjaftonte sikur edhe një ditë të jetoja në një botë të atillë.



1975/26  
Z. A. R.

*ASIMI* — Çështja është të luftojmë pér ta sjellë atë botë.

*IRENA* — Ke të drejtë. Ti gjithnjë thua: komunistët s'kanë pér ta kursyer gjakun e tyre pér atë botë aq të drejtë e aq të bukur (*E menduar*) Asim! Se desh më doli nga mendja: matanë dëgjova se një aksion tjetër po ju pret son te? Aksion tjetër pas atij që ti kreve mbrëmë dhe pas demonstratës sot?

*ASIMI* — Po. Është propozim i Metushit. Në këto çaste kuestura e karabinieria s'e presin një goditje të tillë në qytet. Ata tani janë në hall pér zbulimin e vrasësve të kuestor Sirakuzës.

*IRENA* — Po ç'aksion do të jetë ky?

*ASIMI* — I erdhi radha depos së municioneve.

*IRENA* — Po ajo është e mbrojtur nga roje të shumta, me sa di unë!

*ASIMI* — Mos u bëj merak. Metushi i ka bërë të gjitha llogaritë. Ai në këto punë s'para gabon kollaj...

*IRENA* — Veç kini kujdes mos futeni në lak! Arrestimi i Tel Andonit s'di pse më ka shqetësuar kaq shumë...

*ASIMI* — Vërtet, humbëm një shok me shumë vlerë.

*IRENA* — Po kush ta ketë spiunuar, xhanëm?

*ASIMI* — E ku ta dish.

*IRENA* — Vërtet, s'dihet, po duhet pasur mendja mos ndonjë nga ata që na hiqen si të afërt ta ketë bërë këtë krim.

*ASIMI* — Kurrën e kurrës. Tanët janë tanët, Irenë.

*IRENA* — Sidoqoftë, unë mendoj se s'duhen myllur sytë! (*Ndihen këmbë, hyn Çeliku.*)

*ÇELIKU* — (*S'e sheh Irenën në fillim*) Sa mirë që të gjeta. Do të të kërkoja ngado, mbasi para aksionit do të bëhet një mbledhje me rëndësi të veçantë! (*Irenës që posa e ka parë*) Oh, Irenë! S'të vura re! Mirëmbrëma! (*I jep dorën me përzemërsi.*)

*IRENA* — Mirëmbrëma, Çelik.

*ASIMI* — (*Me interes*) Po ç'është kjo mbledhje e pa pritur me rëndësi të veçantë?

*ÇELIKU* — Bëhet me porosi të Metushit pas arrestimit disa orë më parë të shokut Teno Goreni.

**IRENA** — E arrestuan?!

**ASIMI** — Tenon?

**ÇELIKU** — Dhe a e dini me ndihmën e kujt?

**IRENA** — Të kujt?

**ÇELIKU** — Të një shoku të afërt të Asimit.

**ASIMI** — Shoku të afërt? E pamundur!

**IRENA** — Si?! Po kush do të jetë ky?

**ÇELIKU** — Ju thashë, një i afërt i Asimit, që, po të mundëte, do të na kapte që të gjithëve.

**ASIMI** — Çelik, fol haptazi! Kujt kërkon t'ia veshësh këtë këmishë të zezë, shok?

**IRENA** — Për këto po bisedonim edhe ne. Besimi s'duhet hequr, po edhe sytë s'duhen mbyllur asnjëherë.

**ÇELIKU** — Tamam ashtu është, gjersa në duar nuk ke fakte, po kur ato i ke, atëherë, q'duhet bërë?

**IRENA** — Pse, ç'e papritur ka ndodhur, Çelik?

**ÇELIKU** — S'është e papritur, Irenë, po një e vërtetë e njohur prej kohe. Kolë Dollanaj s'është më njeri që merrret me punët e veta, po një gjarpër në duart e të huajve.

**ASIMI** — Kuush?

**IRENA** — Kolaa? Po Asimi pér të ...

**ÇELIKU** — Fatkeqësisht po. Dikur shok i tij i vegjëlisë e i rinasë, bile edhe «mësues» i tij «i komunizmit», siç e quan ai, po tani agjent i kuesturës dhe varrgërmonjësi ynë.

**ASIMI** — Pse flet kështu, Çelik?

**ÇELIKU** — Jo flas, po kështu është.

**ASIMI** — T'i masësh shokët me këtë kut, s'është shenjë e mirë.

**IRENA** — Le ta dëgjojmë Çelikun gjer në fund.

**ÇELIKU** — Ju që të dy e njihni Teno Gorenin, sidomos Asimi. Ju pyes: ç'mendoni? Ç'njeri është ai pér ju?

**ASIMI** — Një shok i mrekullueshëm, Çelik.

**IRENA** — Edhe unë ashtu mendoj, megjithëse tani vonë e kam njohur.

**ÇELIKU** — Siç e dimë, kohët e fundit, u shkëput nga Kolë Dollanaj dhe shokët e tij, megjithëse atyre, sipas porosisë sonë, ende s'ua kishte pohuar hapët një gjë të tillë. Të nisur nga një varg dyshimesh, dikush prej tyre e kish-

te akuzuar, se diku ishte takuar një herë me Metush Metën. Ai me gjysmë zëri s'kishte munguar t'ia pohonte këtë të vërtetë. Dhe puna kishte mbetur gjer këtu, duke e konsideruar akoma shok të tyre dhe duke shpresuar se me Metushin nuk do të shihej më.

**ASIMI** — C'ka të keqe në gjithë këtë që dëgjuam?

**IRENA** — Mos e ndërpren Çelikun.

**ÇELIKU** — Dëgjo, Asim, dëgjo! Vërtet gjer këtu s'ka asgjë të keqe, por dje, pas demostratës, një e papritur ndodhi. Teno Gorenin e lajmëruan për një mbledhje në shtëpinë e Kolë Dollanajt, ku do të merrte pjesë edhe një nga krerët e ish-Grupit Komunist të «Të Rinjve», i dërguar posaçërisht nga Sadik Premtja e Anastas Lula. (*Mendohet*).

**IRENA** — Vazhdo, vazhdo, Çelik!

**ÇELIKU** — Me ta marrë atë njoftim, ai erdhi të lajmëronte Metushin, me mendimin e prerë që të mos merrte pjesë në atë mbledhje. E kërkuam, por Metushin s'e gjetëm. Atëherë unë vendosa me kokën time. «T'i duhet të shkosh» i thashë Tenos, për të zbuluar nga brenda qëllimet e tyre. Dëgjo gjer t'i kenë zbrazur gjithë bateritë. Pastaj demaskoja hapët dhe deklaroju se ti s'ke punë më me atë bandë grupazhesh. Dhe ai shkoi, po me t'u kthyer në shtëpi nga ajo mbledhje, para se të arrinte të na informonte, u rrethua e u arrestua nga një grup policësh e karabinierësh. Unë dua të di pse pikërisht me të dalë nga ajo mbledhje, e pse pikërisht atë, kur nuk u prek askush tjetër prej tyre?

**IRENA** — E tmerrshme!

**ÇELIKU** — Po. Ashtu si the ti, Irenë. E tmerrshme. Kjo është e gjitha. Dhe kjo më bën të mendoj se autor i këtij krimi është Kolë Dollanaj.

**ASIMI** — Kjo që ka ngjarë, pa dyshim është e hidhur dhe tepër e rëndë, po kjo, Çelik, s'mund të jetë kurrë vepër e Kolë Dollanajt. Si mundet me hamendje të arrish në një akuzë të tillë? Të dyshosh gjer në këtë shkallë?

**ÇELIKU** — Jo të dyshoj, por të kem bindje të plotë se kjo është vepër drejtpërdrejt e Kolë Dollanajt, i dashur

Asim. Ti e di, ne kemi kohë që dyshojmë dhe që e ndjekim veprimtarinë e tij kundër Partisë.

ASIMI — Më vjen keq që të flas me këtë gjuhë, por ti gjithnjë, Çelik, e ke shikuar shtrembër atë. Dhe pikërisht kjo më bën të mos më bindë as edhe kjo akuzë.

ÇELIKU — S'e mohoj. Ashtu e kam vështruar. Por arsyesa ka qenë se në sytë e tij gjithnjë kam diktuar diçka të keqe e të dyshimitë. Dhe jo vetëm unë, por edhe shokët e tjerë.

ASIMI — Kurse unë, që kam jetuar vjete me të, kam diktuar të kundërtën. Dhe më fal, po më duket se kam të drejtë të them, se e njoh më mirë se ti e të tjerët, se vetë puna e pat sjellë ashtu.

ÇELIKU — Ti ashtu mendon, po unë lidhur me këtë që ngjau e me ato që ai vjell prej kohe kundër nesh, i proponozova Metushit ta qërojmë nga faqja e dheut.

ASIMI — (Me hutim e tronditje) Ashtuu?

IRENA — Po Metushi si e priti këtë propozim?

ÇELIKU — Nuk shfaqi mendim. Veçse pasi vuri në dijeni shokët për rrëthanat në të cilat u arrestua shoku Teno Gorenin më tha: «për ta shoshitur punën e Kolë Dollanajt duhet bërë mbledhja e njësitet pa ngurrim.» Veç kësaj, theksoj, se «që prej këtij çasti, Asimi duhet të shkëputë çdo marrëdhënie me të! Ndryshe jeta e shokëve vihet në rrezik. Dhe jo vetëm jeta, po edhe misioni ynë në këtë kantier e në këtë qytet.»

ASIMI — Si? Domethënë edhe atë e ke bindur për të arritur në një përfundim të tillë?

ÇELIKU — Jo e kam bindur, po faktet e sollën atë në këtë përfundim.

ASIMI — Po kjo është e padrejtë, Çelik!

ÇELIKU — Dëgjo, Asim! Shokët kërkojnë nga ti të heqësh dorë. Shoqërimi me të, shpejt a vonë, mund të na verë në pozitë tepër të vështirë.

ASIMI — Domethënë në vend të përpjekjes që bën Partia për t'i sjellë në radhët tona një ditë, ti lufton për të kundërtën?

ÇELIKU — Quaje si të duash, po prej tij duhet të heqësh dorë! Bile doemos dhe menjëherë...

**ASIMI** — (Serioz) Po sikur tē mos i bindem këtij urdhri tē padrejtë? Atéherë q'duhej tē ndodhete?

**CELIKU** — Atéheré, kjo mosbindje do tē quhej anarki, kurse pérkrahja që do t'i japësh Kolë Dollanajt s'do tē ishte, as më shumë e as më pak, veçse miqësi mikroborgjezësh që, pér hir tē tarafeve tē tyre si grupazh, shkelin edhe interesat dhe parimet e Partisë.

**ASIMI** — Si? Gjer këtu arriti urejtja jote ndaj tij e ndaj meje?

**CELIKU** — Unë s'di ta fsheh atë që mendoj. Dhe ja ku ta them: po s'hoqe dorë...

**ASIMI** — Domethënë edhe po më kërcënnon? Të tē vijë zor nga vetja! Asnjeri s'ka guxuar tē më shfryjë e tē më fyejë në këtë mënyrë! (I ndezur, bën një hap drejt Çelikut.)

**IRENA** — (Me shqetësim) Oh, ç'po më shohin sytë! (Ndërhyr)

**CELIKU** — (I patundur) E dimë që je i fortë ti! (Hakmarrës.) Por tani, mbas pak, në mbledhjen e njësitit, sedra jote e sëmurë s'do ta ketë edhe aq tē lehtë tē përgjigjet para shokëve! Naiv dhe mikroborgjez në tē njëjtën kohë!

**ASIMI** — Ashtuu? (I fyter dhe më keq hedh dorën dhe e kap në jakën e xhaketës.)

**IRENA** — Asim! (E tronditur prapë shpejton t'u hyjë në mes.)

(Hyjnë Metushi, Mehmeti, Tafili, Karadaku)

**METUSHI** — Sa keq! Gjer këtu arriti mosmarrëveshja juaj??!

**CELIKU** — Desh t'i bëhej mburojë një spiuni fashist.

**ASIMI** — E dëgjuat me ç'gjuhë flet?

**METUSHI** — (Serioz) Çelik!

**IRENA** — S'do ta harroj kurrë këtë ngjarje tē shëmtuar. Asimi u tregua i ngurtë, po dhe Çeliku nuk u përbajt.

**MEHMETI** — (Irenës) Po si qe puna që u egërsuan kaq fort?

**IRENA** — Çeliku e akuzoi Kolë Dollanajn pér spiun, duke treguar dhe hollësitë e arrestimit tē Tenos, kurse Asimi në asnje mënyrë nuk e pranoi. Pastaj...

**ÇELIKU** — Ja, kjo qe e gjitha. Po për fat të keq Asim Zagora s'do ta pranoj këtë të vërtetë.

**ASIMI** — Në asnjë mënyrë.

**METUSHI** — Shokë! Meqë Çeliku ua paska treguar ngjarjen edhe Asimit e Irenës, mund të them se tani që të gjithë jemi në dijeni gjer në hollësira rrëth arrestimit të shokut Teno Gorenit. Theksoj, me këtë rast se mbledhja e sotme ka rëndësi të dyfishtë. *E para:* Duhet të bindim shokun tonë të armëve, Asimin, për të këputur çdo lidhje me Kolë Dollanajn dhe shokët e tij të vjetër të ish-Grupit të «Të Rinjve» dhe, *e dyta*, pas kaq dyshimesh e faktesh, të vendosim se ç'përgjigje do t'i japim veprimtarisë armiqësore e tradhtare të Kolë Dollanajt. Ju pyes: a ka ndonjë nga ju që s'ka dëgjuar se ç'flet ai kundër nesh? Prá, kundër vijës së Partisë e direktivave të saj! Tezat likuidatore të Sadik Premtes dhe Anastas Lulës kanë lëshuar rrënëjë në gojën e tij. Ai s'kursehet të shprehë me marifet gjoja keqardhjen e vet të thellë se lufta jonë është duke marrë rrugë aventurë, se gjaku ynë, me këtë gjendje shoqërore që ka vendi e përballë një armiku kaq të fuqishëm, është i destinuar të shkojë kot, se shpresa për t'u mbështetur te një fshatarësi që heq këmbët zvarë, siç shprehet ai, s'mund të japë fryt, se bashkëpunimi me nacionalistët është devijim nga interesat e proletariatit e të komunizmit, se propagandimi e sidomos hedhja në aksione e demonstrata kundër fashizmit është një akt provokues që i likuidon kuadrot, që e likuidon Partinë; e, në fund, se lufta e armatosur populllore te ne është një pamundësi e utopi e plotë në këto kushte. A janë të vërteta këto?

**KARADAKU** — Vazhdo, vazhdo, Metush!

**METUSHI** — Kuptohet, të gjitha këto me qëllim që të krijohet mosbesim te Partia, me qëllim që të largohen masat nga lufta. Po kjo është vetëm njëra anë e çështjes, kurse ana tjetër e kësaj medaljeje, pra, kur vjen puna tamam tek fashizmi italian, ai dhe shokët e tij mundohen t'ia zbuluarjnë fytyrën, duke e quajtur të dobishëm këtë okupacion, mbasi Italia, si shtet i madh kapitalist, e nisur nga interesat e saj, do të ndihmojë në ngritjen dhe rritjen e shpejtë të industrisë në Shqipëri e, si rrjedhim, edhe të shtimit e

formimit të proletariatit shqiptar, pra të kolonës vertebrale të një partie komuniste. Vetëm në këto kushte, sipas tij dhe kërëve të Grupit të tij, do të ishte i arsyeshëm formimi i një partie të vetme në vend. E kuptoni, shokë, q'vrer e helm nxjerr ajo gjuhë? Ndërsa popullin mundohet ta trembë e ta largojë nga lufta, armikut i zbuluron ftyrën, okupacionit ia zgjat ditët. Do të mjaftonte vetëm ky fakt, kjo akuzë për të marrë qëndrim ndaj një demagogu e provokatori të tillë të rrezikshëm, i cili s'kursehet me fjalë të përgjërohet për klasën e masën me Marksin dhe Engelsin në gojë. Dhe për këtë, besoj se që të gjithë jemi dëshmitarë.

**CELIKU** — Vetëm ata që s'kanë veshë mund të mos kenë dëgjuar se çfarë flet. Vetëm ata mund të mos e dëshmojnë këtë të vërtetë.

**METUSHI** — Pra, në terenin politik e ideologjik, duke përdorur gjithnjë një frazeologji ultra të majtë, s'ka lënë gjë pa folur. Dua të them, pa shpifur...

**ASIMI** — S'mohohet. Ai dhe shokët e tij, duke qenë jashtë Partisë edhe kanë folur në ndonjë rast, duke i quajtur herë të pamundshme e herë të shpejtura punët tonë. Po tabloja nuk duhet nxirë e gjendja nuk duhet dramatizuar. Sipas mendimit tim, ata kanë rënë në këtë qorrak, jo nga keqdashja, po nga paqartësia dhe mjegulla që akoma kanë në kokë.

**CELIKU** — Helmi që ka vjellë do të ishte gjysma e së keqes, shokë.

**ASIMI** — Po atëherë, sipas teje, cila qenka gjysma tjetër?

**CELIKU** — Ajo që përmenda pak më parë: bashkëpunimi me armikun për asgjësimin tonë.

**ASIMI** — Mos, se nuk është as mirë dhe as e drejtë ta akuzosh tjetrin kështu, Çelik! E kur? Tamam sot kur ai hodhi hapin e parë drejt nesh me daljen dhe fjalën në këtë demonstratë.

**METUSHI** — Asim! Unë mendoj se Çeliku ka të drejtë. Ne duhet t'i lidhim gjérat. Dy javë më parë, polici simpatizant i Lëvizjes, që vepron në kuesturë, na informoi se Kolë Dollanaj në orët e vona të natës i kishte bërë kuesto-

rit një vizitë në zyrë. I huaji e kishte pritur me përzemërsi dhe e kishte përshëndetur me këto fjalë: «Ju jemi mirë-njohës, zoti Dollanaj, për nderin që na bëtë. Kanarina që na dhruuat besojmë se do të na këndojoë bukur!» Por Kola kishte buzëqeshur pa hapur gojën në prani të policit. Unë pyes: kush është ky nder që u paska bërë dhe kush është kjo kanarinë? Mos ndoshta shoku ynë i njësitet, Tel Andoni, arrestuar njëzet ditë më parë. Pas asaj ngjarjeje ne e mprehëm vigjilencën edhe më fort ndaj Kolë Dollanajt.

**ASIMI** — Përse rrëmbehesh kështu, Metush?

**METUSHI** — Nuk rrëmbehem. Nuk u rrëmbyem as kur e arrestuan Telin. Ti e di mirë këtë. Po edhe symbyllur nuk qëndruam. E vëzhuam Kolë Dollanajn, po këtë herë më me kujdes, mbasi ai, siç e përmenda dhe më lart, kishte kohë që nuk merrej vetëm me punën e tij. Prandaj, duke u mbështetur tek të gjitha ato që thashë, e sidomos tek informata që sjell Çeliku sot pér arrestimin e shokut Teno Gorenin, me të dalë nga ajo mbledhje e tyre, ti duhet të bindesh e të përkrahësh çdo qëndrim që do të marrin shokët kundër tij. Ky do të jetë edhe guri i provës, Asim . . .

**ASIMI** — Po të kenë arsyë, po.

**ÇELIKU** — Arsyë? Po a ka fakt më të gjallë se kjo që ndodhi sot?

**ASIMI** — Ky është supozim e jo fakt, Çelik! Aq më tepër si mund të mbështetemi në hamëndje kur bëhet fjalë pér jetën a vdekjen e një njeriu? Jo, unë këtë nuk do ta pranoja kurrë.

**METUSHI** — Nuk është ashtu, Asim! Të lëshojmë pe në këto çështje, do të thotë të vëmë në rrezik punën e Partisë dhe jetën e shokëve. Po ne s'kemi pér ta bërë kurrë një lajthitje të tillë.

**KARADAKU** — Unë e përkrah këtë qëndrim. Faktet janë të mjafta dhe bindëse. Cili është nderi që Kolë Dollanaj u paska bërë dhe cili qenka zogu që u paska dhuaruar?

**ASIMI** — Unë mendoj se marrëdhëniet e tij me ta s'duhën shikuar kaq ngushtë. Ai është jurist dhe puna vazhdimi shqiptar e lidh me kuesturën dhe karabinierinë . . .

*ÇELIKU* — (*Me ironi*) Ha-ha-ha! Kësaj i thonë: për të qarë e për të qeshur.

*ASIMI* — Përse çuditesh? Ata shpesh i thërrasin avokatët, e, në këto hyrje e dalje kushedi se ç'nder kuestori mund t'i ketë kërkuar dhe ai t'ua ketë bërë. Po a mjaf-ton kjo për të arritur në përfundimin se Kolë Dollanaj është shitur tek i huaji e tanë po na pregatit kurthi edhe ne të tjerëve? Kush, si ai, ndër avokatët e këtushëm i ka marrë në mbrojtje të akuzuarit politikë, pra, shokët tanë, pa llogaritur rreziqet që mund t'i sillte vetes? Cili nga ne s'e di këtë të vërtetë, për të cilën flet një qytet i tërë? Po a ka mundësi që një njeri i tillë të jetë edhe mbrojtësi edhe denoncuesi i tyre? E në këtë rast edhe i Teno Gorenit? Jo. Këtu nuk ka logjikë, shokë. Unë këtë as e pranoj dhe as e besoj kurrë!

*ÇELIKU* — Ti jo, por ne, po. Për mendimin tim, spuanit Kolë Dollanaj i duhet kënduar kulufruthi menjëherë. Këtë mendim, ja ku e them sot, ia kam propozuar me kohë edhe Komitetit Qarkor të Partisë.

*ASIMI* — Komitetit Qarkor të Partisë? Duke e cilësuar si spiun? Sa keq! Ti ke vepruar me paramendim e pasion, Çelik! E kjo më bind edhe më shumë të mos i zë besë as informatës që po sjell sonte.

*ÇELIKU* — Ti mund të mos i zësh besë, por unë jam gati t'i vë të dy duart në zjarr për këto që po i them Partisë.

*MEHMETI* — Asim, mos kujto se ne të tjerëve s'na dhimset jeta e njerëzve kur janë në punë të vet. Edhe unë i kam kundërshtuar dyshimet e mëparshme të Çelikut. Por informata e policit simpatizant më ka bërë të mendohem shumë, kurse kjo e sotmja e Çelikut i vuri kapak...

*TAFILI* — Dikur dhe unë jam lëkundur, por koha më bindi plotësisht. Çeliku ka të drejtë.

*IRENA* — Plotësisht të drejtë...

*KARADAKU* — Edhe unë ashtu mendoj.

*ÇELIKU* — Pra, shokë, kemi vetëm një që e mbron. Sidoqoftë unë propozoj për Kolë Dollanajn: gjysmën e lekut! Kryerjen e vendimit, po të mos keni kundërshtim, e

marr përsipër unë. E tani, propozimi që bëra, sipas parimit, kërkoj të hidhet në votë.

*ASIMI — (I trondit tur thellë)* Në votë?! Po si është e mundur të ngremë dorën kundër një njeriu që nuk i do më pak se ne popullin e atdheun, proletariatin e komunizmin? Një njeriu, që tamam tani, kur po mundohet të afrohet drejt nesh, t'i kthejmë grykën e pushkës? Edhe përmbetjen e tij e të shokëve të tij jashtë radhëve tona gjer më sot, llogari duhet t'i kërkohet krerëve të grupit për letrën «udhëzuese» që dërguan qysh në nëntor të 41-së, e jo Kolës, i cili është viktimë e një urdhri të padrejtë të parëve. Unë e Tafili që andej vijmë dhe besoj se si njëri dhe tjetri e mbajmë mend mirë porosinë e asaj letre: «Përkohësish, — thuhej në të, — nuk do të bëni pjesë në radhët e Partisë së porsaformuar gjer në një urdhër të dytë nga Qendra e Grupit». E ai urdhër, me sa di unë, nuk i erdhë kurrë Kolë Dllanajt. Prandaj, shokë, unë as e pranoj dhe as marrë pjesë në një votim të tillë!

*METUSHI — (Serioz e solemn.)* Asim, le t'i lemë keqardhjet. Gjer një muaj më parë, siç e thanë vetë, edhe Mehmeti e Tafili ngurronin. Po ngjarjet e faktet kanë gjuhën e tyre të gjallë. Dhe neve, si ushtarë të Partisë, s'na mbetet gjë tjetër veçse t'i shohim ndër sy e të marrim qëndrim. Prandaj edhe një herë të ftoj: le t'i lemë keqardhjet e le ta themi gjer në fund fjalën tonë! Pra, shokë edhe unë, si dhe më parë, jam po në një mendim me Çelikun: Në votë! (Të gjithë ngrenë dorën përveç Asimit)

*ASIMI — Domethënë gjithçka mbaroi?*

*ÇELIKU —* Sigurisht. Kundër dëshirës sate, Asim Zagara. Veç dua të di: pse të ngjaka i padrejtë ky vendim i shokëve e t'u dukërkë me vend t'i bëhesh avokat mbrojtës një agjenti fashist? Sa turp, dhe i thua vetes revolucionar e bille edhe komunist!

*MEHMETI — (Me seriozitet dhe zemërim) Çelik!*

*KARADAKU — (Çelikut)* Po pse me të nxeh të, xhanëm?

*METUSHI —* Asim!... Unë e kuptoj sa të vështirë e ke të besosh në keqësinë e njerëzve e aq më tepër të atyre që ti i njeh e i do. Po faktet janë fakte, dhe ato duhen

pranuar ashtu si janë. Mblidh veten, shok, dhe gjykoje më me të qetë këtë vendim që morëm së bashku. Çdo lë-kundje a shkëputje të çon matanë barrikadës. E kjo dëmt-ton Partinë, ne, e sidomos ty...

*ASIMI* — (*Metushit*) I kuptova të gjitha... (*Celikut*) Kurse ty, Çelik Zana, ja ku po ta them ndër sy: askush s'ka guxuar gjer më sot të më fyejë në këtë mënyrë. Arrite gjer atje sa të më akuzosh edhe si avokat mbrojtës të një agjenti fashist. Po mos harro, se njeriu, që sot ti dhe Metush Meta po dënoni me vdekje, éshtë ndër të parët që ka sjellë fjalën komunizëm në këtë kantier.

*METUSHI* — Sa për fjalën e rëndë që nxori nga goja, mos iu zemëro, Asim! Ai e ka këtë zakon të prapë. Kurse në këtë zbulim ai ka jo vetëm të drejtë, por edhe meritë.

*ASIMI* — Po, po. Tani e kuptoj fare mirë se sa ka të drejtë dhe meritë. Në djall kjo punë me paramendim. Po në e mësoftë Partia të vërtetën e hidhur të kësaj nate, ma merr mendja, s'do ta kini të lehtë t'i përgjigjeni drejtësisë së saj. Kokat e njerëzve s'janë topa leckash që t'i varrosni me një dyshim.

*IRENA* — Asim!

*ÇELIKU* — (*Metushit*) Kot kërkove t'i hedhësh verës ujë. Unë e përsëriss: jo vetëm mbrojtës i një agjenti të ar-mikut, por edhe i lehtë e naiv pa fund!

*ASIMI* — (*Me zemërim*) Veçse mbaji mend edhe këto fjalë! (*Bën një hap drejt Çelikut.*)

*IRENA* — (*Duke i prerë rrugën.*) Asim!

*METUSHI* — (*Me seriozitet.*) Asim! (*I del përpara.*)

*ASIMI* — E kuptoj! Midis ju të dyve dhe meje tani qëndron një det i paanë!

*MEHMETI* — (*Me qërtim*) Sa keq! Nuk i prisja prej teje këto fjalë...

*ASIMI* — Mos u shqetëso, Mehmet. S'kam bërë gjë tjetër veçse s'po pranoj të bëhem bashkëveprues në këtë krim. Unë mësues jam në një katund këtu pranë, ku ka edhe një sektor të prodhimit të naftës, e ku unë bëj edhe jetën si anëtar i grupit edukativ. Dhe ashtu do të vazhdoj. Pra dhe atje ka luftë dhe jetë partie. Ndaj të mos kujtojë njeri se po dezertoj. Partia një ditë ka për ta zgjimi

dhur edhe çeshtjen time. Unë e kam të patundur këtë besim! Po edhe në ndodhtë që e drejta të jetë me Metush Metën e Çelik Zanën, Asim Zagora do të ketë aq guxim e ndershmëri në veteve sa të kthehet tek shokët për ta gjykuar ata siç i takon.

*MEHMETI* — (Me dhembje.) Po pse kështu, more trim?

*ASIMI* — Ty dhe të tjerët, kurrë s'do t'ju harroj, Mehmet! Mirë të shihemi! (Merr yrysh të dalë.)

*METUSHI* — Mendoje mirë këtë hap që po bën!

*IRENA* — (E trondit) Po a e kupton se kjo shkëputje në këtë mënyrë?... (I pret rrugën)

*ÇELIKU* — Pse s'e plotëson mendimin? Për ata që shkëputen, si Asim Zagora, s'ka më kthim.

*ASIMI* — (Duke e mënjanuar Irenën, Çelikut) Mos të të hajë ai merak! Veçse edhe këtë fjalë mbaje mend, Çelik Zana! (Del me rrëmbim).

*METUSHI* — (Me qërtim e zë të lartë) Asim! Asim! (Ikën. Gjendje e nderë. Pauzë e gjatë. Metushi duke ndezur një cigare). Sa keq! Ai nuk është aspak i bindur në drejtësinë e vendimit që morëm sot. (Mendohet) Megjithatë, një njeri i drejtë e i fortë si ai, një ditë do ta gjejë rrugën për te shokët. Unë e kam të fortë këtë besim.

*MEHMETI* — Edhe unë besoj po ashtu, Metush. Ai, sinqerisht, me mendje e më zemër s'arrin ta kuptojë rrezikshmërinë e Kolës.

*ÇELIKU* — Kurse unë mendoj të kundërtën tuaj. Siç e thashë edhe më parë, për ata që shkëputen, si Asim Zagora, s'ka më kthim. Pas largimit, ata kthehen në gjarginj.

*KARADAKU* — Jo, mos fol ashtu për të, Çelik.

*IRENA* — E tmerrshme! Për kë u prish ai me shokët!

*TAFILI* — (I trondit) Akoma më duket si èndërr (Pauzë e gjatë. Gjendje e tendosur. Hyn Besa.)

*BESA* — Shokë, Kolë Dollanajn e arrestuan!

*ÇELIKU* — Çfaaarë?!

*ZËRA* — E arrestuan?!

*BESA* — Po. Të lidhur; 4 policë e kishin futur midis,

ndërsa marshall Gabrieli iu printe në krye. Kola, i përgjakur në fytyrë, e cte me kokën lart.

**KARADAKU** — I përgjakur? Kola?!

**BESA** — Po, Kola.

**MEHMETI** — E pabesueshme!

**METUSHI** — Të thanë, apo e pe me sytë e tu?

**BESA** — E pashë. Bile në mes të pjacës. Në popull flitej se e kanë arrestuar si organizator të demostratës. Duke ardhur, ndesha edhe Asimin. Ishte i trishtuar dhe i përlotur. E pyeta se ç'kishte, po nuk më tregoi. Pastaj i rrëfeva pér Kolën. S'di pse i ndriti fytyra kur dëgjoi pér arrestimin e tij. Megjithatë, prapë më pyeti: «E pe me sy të arrestuar, apo ta thanë të tjerët?» (*Pauzë e gjatë*).

**KARADAKU** — Po pastaj?

**BESA** — Pastaj, si e sigurova se e pashë me sy, mori frysë si içliruar nga ndonjë ankth mbytës e tha: «Shumë mirë, Besë. S'do të bëje keq t'ua thoshe edhe shokëve atë që pe me sytë e tu». Dhe iku...

**METUSHI** — (*Shokëve*.) Tani, ai që u shkëput do ta ketë edhe më vështirë të bindet në drejtësinë e vendimit tonë.

**BESA** — (Me shqetësim.) U shkëput, the?

**METUSHI** — Po. (*Pauzë*.) Veçse dhe ky arrestimi i tij është diçka që të huton pér një çast.

**MEHMETI** — Vërtet gjë që s'pritej!

**ÇELIKU** — (*Me dyshim, Besës*.) I përgjakur the?

**BESA** — Po. Fytyrën e kishte të përgjakur.

**METUSHI** — Megjithatë, mua prapë s'më besohet se një njeri si Kolë Dollanaj mund të arrestohet nga armiqtë.

**MEHMETI** — Sidoqoftë, në kushtet që u krijuan, mendoj se Partia duhet ta hetojë më me të qetë këtë çështje. Le të pranojmë pér një çast se në jetë ka edhe kthesa, edhe pendime...

**KARADAKU** — Veçse ky veprim duhet kryer pa humbje kohe.

**METUSHI** — (*I menduar*.) Dakord. Ngarkohesh ti, Karadak, të vësh në dijeni njeriun tonë të brendshëm në

kuesturë për ta hetuar sa më parë e gjer në fund enigmën e këtij arrestimi.

KARADAKU — Po i shkoj, me të dalë nga kjo mbledhje.

METUSHI — Mirë. (*Shikon orën*) Paska ardhur koha. Shokët e ngarkuar për aksionin e sontshëm, mbas një gjysmë ore duhet të ndodhen në vend. Le të fillojmë të dalm! (*Dalin*).

IRENA — (E trishtuar, duke dalë e parafundit nga skena.) E tmerrshme! S'do ta harroj kurrë këtë natë! (Del. Në skenë mbetet vetëm Besa. E tronditur, ulet dhe mendohet. Hyn teto Katina.)

TETOJA — Këtu qenke, moj bijë?

BESA — (Duke mbledhur veten) Këtu, teto Katinë!

TETOJA — Të pastë nëna! Po Mërkuri vallë?

BESA — Në shaptilograf, si gjithmonë...

TETOJA — I shkreti djalë! Megjithëse i sëmurë, punon sa për katër! Mbrëmë s'futi kafshatë buke në gojë! (*Diç i nxjerr nga dollapi për të ngrënë*) Po shkoj ta thérres. Metushi shpesh më pyet për të e më lut ta kem në kujdes. Dhe unë s'e ndaj atë nga Vasoja, moj Besë.

BESA — Jo, ti qëndro, teto Katinë. Po shkoj unë ta zëvendësoj. Kështu, dhe shaptilografi nuk do të heshtë...

TETOJA — E mirë e nënës! (*Vë një pjatë mbi tryezë. Në të një copë bukë misri dhe pak turshi e djathë*.) I shkreti djalë! Është bërë koskë e lëkurë! (Hyn Mërkuri.)

MËRKURI — Më kërkove, teto Katinë?

TETOJA — Po! Po ti vdiqe për të ngrënë, more bir!

MËRKURI — Kur kemi punë...

TETOJA — Po puna punë dhe ushqimi ushqim!

MËRKURI — (Duke ngrënë me shije) Tani po e kupoj se më paska marrë uria!

TETOJA — Eh, bir, bir! Natë e ditë në punë...

MËRKURI — Punë i thonë asaj të atyre që po luftojnë, teto Katinë...

TETOJA — E kush nga ju s'po lufton, more Mërkur?

MËRKURI — Ja, pikërisht unë...

TETOJA — Jo, more bir! Mos e thuaj atë fjalë. Edhe kjo është luftë...

*MËRKURI* — Luftë i thënçin. Më qan zemra që s'jam përkrah tyre kur sulen mbi armiqtë. Megjithatë edhe në shaptilograf ndiej një lloj gëzimi ngandonjëherë. Ndoshta, siç the, edhe kjo është një farë lufte, teto Katinë. Lajme që të habitin mendjen. Sabotimi i naftës arriti kulmin këto ditë.

*TETOJA* — E kam dëgjuar. Po si e sabotojnë, xhanëm?

*MËRKURI* — Fare thjesht. Ja më dëgjo! Ti e di që puset janë të lidhur me rrotat me shufra hekuri apo çeliku. Por në vend që çdo pus, fjala vjen, ta lidhin me rrotën 12 orë në ditë, punëtorët e vënë në veprim 6 ose 8 orë. Kështu, nëse ai do të jepte 12 mijë litra naftë, për 6 ose 8 orë punë, jep 6 ose 8 mijë litra. Po në raportet ditore punëtorët shënojnë: «Punoi 12 orë, dha 12 mijë». Kështu raporti në drejtori shkon në rregull e po ashtu telegrami ditor që i dërgohet Romës, po nafta në depo mungon vazhdimisht. Dhe kjo i ka alarmuar. Kontrollorët, të shqetësuar, vijnë vërdallë. Po kush i zbulon dot punëtorët, që me syrin shpuzë i rrinë në krye kësaj pune ditë e natë?

*TETOJA* — Po më habit, more Mërkur! Sa shkurt i paskan rënë punës!

*MËRKURI* — Kështu, teto Katinë. Tani ata që marrin pjesë në këtë luftë s'janë më një grusht njerëzish të zgjedhur, po të gjithë proletarët e kësaj qendre të madhe të naftës. (*Befas e pret fjalën. Le lugën dhe ngrihet në këmbë. Në largësi dëgjohen shpërthime. Pastaj nga flakët një dritë e fuqishme mbulon qytetin dhe reflektohet edhe në skenë.*)

*TETOJA* — Ç'flakë! (*Del e shikon në dritare. Jashtë dëgjohen vërvhellima bilbilash të policisë, hapa dhe, në thellësi, gjëmimë e të shtëna pushkësh.*) I dëgjon?

*MËRKURI* — (*Hesht e përgjon*). Tek e mendoj se si luftojnë tanët, më duket vetja mizë përpara tyre!

*TETOJA* — (*E shqetësuar nga të shtënat e pushkëve që fillojnë të shpeshohen. Gjithmonë te dritarja. Si me veteve.*) Eh! Bjtë e nënave! Bjtë e nënave! (*Erret drita. Te dritarja shquan silueta e Tetos.*)

## SPIKERI —

Fle qyteti, fle dhe lumi  
rreth e rrotull qetesi,  
po ty pse s'te marrka gjumi,  
teto, prehje, pse s'gjen ti?

Heshturaz, fytyrëzbetë,  
syte kodrés nuk ia ndan?  
flak' e kuqe ndezi retë,  
teto moj, po fryn tufan!

C'rri e vetme në dritare?  
Jashtë errët e kiamet.  
fol, moj nënuia luftëtare,  
kësaj nate kë po pret?

Riten flakët, hapen zjarre,  
thellë kodra bubullon,  
qeshet tetua në dritare  
dhe të zbetët i kalon!

(Zhurma largohet. Të shtënati pushojnë, ndërsa flaka që pushton qytetin reflektohet edhe më e fortë në dhomë).

TETOJA — (E gëzuar. Që nga dritarja.) Kaluan më duket...

MËRKURI — Me siguri Metushi e Asimi do t'uа kenë ngatëruar gjurmët. Askush s'uа kalon atyre për shkathësi në luftime!

TETOJA — Po mua Irena më tha se Asimi me Vason do të shkonin diku në një mbledhje, more bir?

MËRKURI — (Për ta qetësuar.) Gjersa të ka thënë, ashu do të jetë, teto Katinë. (Befas sërisht ndihen pushkë në afërsi. Pastaj një trokitje e fortë dëgjohet në derë.)

TETOJA — (Me zë të ulët.) Krejt ndryshe nga mënyra e të trokiturit të djemve! E dëgjon? Po kush vallë do të jetë? (Mban vesh dhe pret. Trokitja përsëritet. Tetoja ul fitilin e llambës dhe prapë s'përgjigjet.) Mërkur, largohu bir! (Mërkuri del. Mbas pak dera përsëri troket.) O shën Mëri! Po përse ngulmon kaq shumë? (I hap derën.) Në prag me një elektrik dore duket mësuesi plak Sokrat Isau.)

MËSUESI — Më fal, motër Katinë, më fal që po të shqetësoj në këtë kohë.

TETOJA — (Duke marrë veten.) Ti, zoti Sokrat?

MËSUESI — Pashë flakë e më vajti mendja te djemtë... Me siguri ata do t'i kenë vënë...

TETOJA — Si të të them, zoti Sokrat...

MËSUESI — Ata, ata... Po dalçin pa dëm, moj Katinë. Me siguri edhe Sotiri im atje do të jetë.

**TETOJA** — E ke parë, zoti Sokrat?

**MËSUESI** — Që kur është hedhur në ilegalitet, rrallë e fort rrallë... Veç, paçin jetën e gjatë, paçin jetën e gjatë. (Në thellësi ndihen përsëri të shtëna pushkësh e revolveresh. Mbajnë vesh, pushkët pushojnë).

**TETOJA** — Eh, bijtë e nënave! Kaq të mitur u bëtë nderi i Shqipërisë.

**MËSUESI** — Ashtu vërtet. Veç falmë, motër Katinë, që të shqetësova në këtë orë, falmë. Natën e mirë e kij kujdes, motër!

**TETOJA** — Natën e mirë, zoti Sokrat. (*Mësuesi del. Tetoja i vë llozin derës. Mbas pak përsëri dëgjohen të shtëna pushkësh.*) Akoma qëllojnë të mallkuarit! (*Shikon nga shën Mëria*) Ruaji, zonjë! (*Shkon te dritarja dhe mundohet të vështrojë jashtë. Mbas pak, një trokitje në formë sinjali dëgjohet nga deriçka që del në bahçe. E gëzuar.*) Erdhën! (U hap derën. Hyn Karadaku e pas tij Vasoja. Vasos) Ti? Po ku ishe gjer tani, more firaun?

**KARADAKU** — (Me përzemërsi.) E kemi thënë, ku-reshtja në këto punë s'është gjë e mirë, teto Katinë! Ajo vetëm na dëmton!

**TETOJA** — Jo, po mua... Irena...

**KARADAKU** — (Gazmor.) Eh, teto, tetoja jonë e urtë! (E përqafon.)

**BESA** — Si dolët, Karadak?

**TETOJA** — Si dolët, bir?

**KARADAKU** — Ua punuam paq, teto Katinë. Kishim kohë që ia kishim vënë synë depos së munitioneve në Kuçovën e Vjetër.

**TETOJA** — Po. Po pastaj?

**KARADAKU** — Pastaj, si u err mirë, Tafili, në befasi, iu afroa rojes e i vuri nagantin në gjoks, kurse të tjerët, me Metushin në krye, si e spërkatën me benzinë, i vunë flakën ndërtëses.

**BESA** — Ju lumtë!

**KARADAKU** — Tani, policë, karabinierë e këmishëzes po përfyten me flakët.

**TETOJA** — (E gëzuar) Të rroni, more bij! Veçse kujdes duhet pasur edhe më shumë.

**KARADAKU** — (*Buzagaz e me mirëdashje*) Mos ki merrak! (*Besës*) Besë, natën e mirë! Natën e mirë, teto Katinë! (*Matet të largohet*).

**TETOJA** — (*E mban*) Ku, more mir? Ku kërkon të shkosh në këtë orë?

**KARADAKU** — Në një bazë tjetër, Ika, ika! Natën e mirë! (*Del me rrëmbim*).

**TETOJA** — Veri është, moj Besë! Por unë e kuptoj: atij i vjen zor të qëndrojë tek na shikon që jemi ngushtë. Po kush, moj bijë, nga dora jonë ka pasur bollék ndonjëherë? Ja, edhe sonte nga dy domate turshi do të kemi, si ngaherë... (*Vasoja del e shkon në dhomën matanë*)

**BESA** — Do të vijë dita kur edhe bollëku s'do të na mungojë, teto Katinë.

**TETOJA** — Dikur, në 39-tën, kur erdhën së pari qafirët, me ca punëra që hapën, u duk sikur e zgjidhën qesen, po tani këtij qyteti ka kohë që i mungojnë kroda dhe çorba.

**BESA** — Ashtu vërtet. Veçse sofrat e zbrazëta janë më të tmerrshme se lumenjtë në vërshim dhe më të egra se flakët kur mbulojnë shtëpitë! A të kujtohet demostrata e bukës gjashtë muaj më parë?

**TETOJA** — Si jo, moj bijë.

**BESA** — Ajo ishte marshimi i atyre sofrave, teto Katinë!

**TETOJA** — E drejtë. Qytetarët kanë kohë që po ua shtojnë vrimat rripave të brezit.

**BESA** — E kur rripat ngushtohen fort, fytyrat zbehen e sytë errën. Pastaj, pas atij të erruri, vjen furtuna, që gjë më nuk e mban!

**TETOJA** — Ashtu, moj Besë, ashtu! (*Hyn Vasoja. I ner-vozuar. Ulet mënjanë dhe mendohet*)

**BESA** — Dhe ne, në propagandën tonë me gratë, kur u flasim për luftën, duhet ta lidhim atë edhe me këto kushte mjerimi e urie që na mundojnë kaq fort.

**TETOJA** — Ke hak... (*Ngrihet*) Po sjell të hamë! (*Del*)

**BESA** — (*Vasos*) Po ti ç'ke që je kaq i ngrysur?

**VASOJA** — Për armiqtë s'e vrash mendjen, Besë, por për shokët po! Kur ata s'besojnë sa duhet në burrërinë ti-

me, atëherë s'jam aspak i qetë. Dhe kjo kuptohet: bile edhe në aksione rrallë më marrin, po edhe kur më marrin, më lënë si bisht nga pas. Besomë: më erdhi plasje kur edhe sonte në sy të tjerëve, Çeliku më tha me thumb: «Ki mendjen, Vaso! Frontin më të vështirë ty po ta besojmë! Siç e shikon, prapë po të lëmë praparojë të na mbrosh krahët nga armiqjtë e tradhtarët e atdheut!» E kupton ç'të tallur? Po si e harruan xhanëm kush e qëlloi togerin e militisë me grusht në fytyrë? E ku pa? Mu në mes të rrugës! Më ra dhe unë i rashë menjëherë.

*BESA* — Mos ia merr për ters, Vasil. Ai gjithnjë kështu i bën shakatë.

*VASOJA* — Ama, të bukur shaka! Po do ta shikojë ai se kush është Vaso Gjika! (*Tetoja shtron për të ngrënë. Ulen rreth tryezës, fillojnë të hanë*). Ja ku ta them: vetëm Asimi më do dhe më ka në hesap....

*BESA* — Eh, Vaso, Vaso! Kot që e vret mendjen për këtë punë... (*Befas dëgjohen të goditura në derë. Pastaj zëra*.)

*ZËRA* — Hapeni! Kuestura! (*Ndërkaq të goditurat dëgjohen edhe nga dericëka nga ana e kopshkit*.)

*TETOJA* — (*E tronditit*.) Po tani?

*VASOJA* — (*Duke e përbajtur shqetësimin*.) Asgjë s'kanë ç'të na bëjnë, veçse materialet që të ka lënë Sotiri a i ke fshehur në vend të sigurt?

*TETOJA* — Në tavan, Vasil! (*Jashtë, përsëri, nga të dy anët, nga porta dhe nga dericëka dëgjohen goditje dhe zëra*.)

*ZËRA* — Hapeni! Hapeni po ju themi! Kontroll! Kuestura!

*VASOJA* — (*Nxjerr nga një valixhe aty pranë një libër dhe e vendos mbi tryezë. Pastaj i bën shenjë s'ëmës ta hapë derën. Tetoja me droje vete ta hapë derën. Besa shkon në dhomën matanë. Pas këtij veprimi, kapiten Anxhelo, me revolver në dorë, hyn në dhomë e, pas tij, marshall Gabrieli. Me të hyrë, ai vë re Vasilin në tryezë; po Vasaja, pa luajtur nga vendi, vazhdon të hajë. Libri qëndron me faqet e hapura*).

*OFICERI* — (*Duke e marrë librin në duar*) Ç'është ky

libër këtu pranë, djalosh? (*I hedh një sy titullit.*) Kuore? De Amiqis? Lexokeni edhe autorë italianë! Shenjë e mirë, sijnorino...

*VASOJA* — Është një italian i madh, zotëri.

*OFICERI* — Më vjen mirë për përgjigjen, djalosh.

*VASOJA* — Ju falem nderit, zotëri.

*OFICERI* — (*Marshallit*) Gabriel, ndërsa ne vazhdojmë bisedën, kontrollo ti!

*GABRIELI* — Sinjor si! (*Me revolver në dorë kalon në dhomën matanë*)

*OFICERI* — (*Vasos*) A ka njeri matanë?

*VASUA* — Ime kushërirë.

*OFICERI* — Po në shtëpi?

*VASUA* — Këto dy dhoma janë gjithë shtëpia jonë. Asnjeri tjetër nuq ka veç njerëzve që shikoni këtu e asaj që ndoshta fle matanë.

*OFICERI* — Thuhet se këtu tani porsa janë parë njerëz të dyshimtë.

*VASOJÀ* — Ju kanë informuar keq, zotëri.

*OFICERI* — Të të besoj?

*VASOJA* — Kjo varet nga ju.

*OFICERI* — Më pëlqen mënyra e prerë e fjalës sate! Po në ndodhtë ndryshe, djalosh? Dhe mos harro se je një nga gjimnazistët e përjashtuar për pjesëmarrjen në demonstratën e tetorit të 41-së në Tiranë.

*TETOJA* — (*Oficerit.*) Mos e hutoni kështu, more zot! Ai u ndodh rastësisht në atë demonstratë.

*OFICERI* — (*Tetos.*) Mos u shqetësoni, zonjë! Po pa ta shikojmë pak atë «kushërirën» tuaj që «ndoshta» fle! (*I bën shenjë të vijë ta marrë.*)

*TETOJA* — Të vijë këtu?

*OFICERI* — Po. (*Tetoja del. Vasos*). Domethënë ti je i sigurt përsa më the?

*VASOJA* — Kujtoj se po, zotëri! (*Oficeri i qaset dhe e shikon ngultas në sy duke i vënë dorën në mjekër. Edhe Vasoja e shikon po ashtu.*)

*OFICERI* — Paske sy të fortë, djalosh. Më pëlqen guximi dhe qëndrimi yt.

*VASOJA* — Falemnderit, mirësia juaj, zotëri! (*Hyn te toja me Besën.*)

**OFICERI** — Ahaaa! Kjo është kushërira!... Paskeni ku-shërirë të bukur!

**VASOJA** — Ehë!

**OFICERI** — (Besës.) Ç'keni kërkuar këtu, sinjorina?

**BESA** — Unë jam mbesë në këtë shtëpi. Nga malli vij shpesh.

**OFICERI** — Interesant! Nga malli vini shpesh! Pooo... (E shikon ngultas me qëllim që të zbulojë të vërtetën dhe ashtu si Vason e kap pér mjekre.)

**BESA** — Ju lutem, mos më prekni me dorë! (E shikon egër dhe zmbrapset.)

**TETOJA** — (Duke ndërhyrë) Ajo është çupë, more zot, si e prekni ashtu?

**OFICERI** — Çupë, ë? (Hyn Gabrieli.)

**GABRIELI** — Posa zbrita nga tavani, zoti kapiten. Ja ç'plaçka me vlerë që ruan ky bukurosh atje! (Lëshon para tij një vandak traktesh e komunikatash.)

**OFICERI** — Pa shih, pa shih, pa shih!

**GABRIELI** — Besoj, zoti kapiten, se s'ka nevojë pér tjetër dokument. Ja dhe ky shënim mbi këto fletushka: «Vasos pér t'i shpérndarë. — Sotiri».

**OFICERI** — (Duke u errur në fytyrë) Sotiri? «Illegali» Sotir Isau?! Lexonjësi i De Amicisit bashkëpunëtor i kriminelit Sotir Isau dhe me siguri edhe i Metush Metës? Ahaa! Atëherë fol, ku ndodhen ata në këtë orë? (E zë me të dy duart pér supesh.)

**VASOJA** — Unë nuk kam njohje me kriminelët, zotëri. Shokët e mi, që të gjithë janë njerëz të mirë e të ndershëm.

**OFICERI** — Mos u mundo të më dredhosh... Trego, po të them! Ku ndodhen ata në këtë orë?

**VASOJA** — As e di dhe as i njoh, zotëri.

**OFICERI** — (I nxehur.) Eh, krimb i ndyrë! (E qëllon me pëllëmbë.). Po tani a i njeh dhe a i di?

**VASOJA** — Siç ju thashë edhe më parë të tillë Sotirë dhe Metushë, gjer më sot nuk kam njohur, kapiten! (Duke e shikuar egër oficerin.) Ata që njoh unë janë kryetrima dhe do të mjaftonte vetëm një vështrim i tyre, pér të hedhur përdhe cilindo kundërshtar.

*OFICERI* — (Duke i vënë duart në grykë.) Ashtu, ë? Atëherë fol: ku ndodhen ata? (E qëllon) Të pëlqen, ë (Dhe prapë e zë pér gryke.)

*BESA* — (Duke ia hequr nga duart). Lëshojeni! Kérkonni të mbytni një fëmijë?

*VASOJA* — Ju dini të qëlloni të pambrojturit, zotëri, kurse ata ua thyejnë dhëmbët kundërshtarëve të tyre sado të fuqishëm që të jenë. Mos guxon i t'iu dilni përpara, se mund t'ju dëmtojnë rëndë, kapiten!

*OFICERI* — Si, siii? Guxon të më flasësh pér ta edhe me këtë gjuhë?

*GABRIELI* — I vogël, po gjarpër, zoti kapiten!

*OFICERI* — (Duke e shtrënguar fort pér gryke.) Të paskan bërë edhe komunist, të fëlliçurit! (*Besa derdhet t'ia heqë nga duart, Gabrieli i pret rrugën.*)

*VASOJA* — Ata janë të pastër si rrezja e diellit, kapiten! Thonë se komunistët duhet të jenë njerëz të një brumi të veçantë. E pastaj dhe trima dhe me zemër të madhe. Po të isha i atillë, duhej t'ju isha përgjigjur ndryshe, zotëri!

*OFICERI* — Pér shembull, si?

*VASOJA* — Pér shembull, ndoshta (*Si i menduar.*) kështu: Ptu! (E pështyn dhe papritur e qëllon me grusht me tërë fuqinë e tij. Oficeri përbysët. Vasoja shpejton të ikë. Besa mundohet t'i presë udhën oficerit të porsa ngritur, po prapa derës, dy policë me revolverë në duar e ndalin Vasson dhe e fusin prapë në dhomë.)

*OFICERI* — Po tani, shoku komunist? (*Mundohet ta qëllojë me pëllëmbë, po Besa i del përpara dhe e pengon. Gabrielit.*) Lidheni, dhe menjëherë drejt e në kuesturë! (*Policët shpejtojnë dhe e lidhin.*)

*TETOJA* — T'ju vijë turp! Kini frikë nga një fëmijë!

*OFICERI* — (Me ironi.) Tani mos kini më merak pér të, sinjora...

*VASOJA* — Mos u thyej, nënë! (*Hyn rreshter Ugolini*)

*RRESHTERI* — Zoti kapiten! Lajmërojnë se Metush Meta tani vonë posa është parë në lagjen punëtore matanë. Sipas urdhërit të komandës edhe forca jonë duhet të kalojë në atë krah!

*OFICERI* — Fort mirë, Ugolin! (*I bën shenjë Gabrielit ta nisë Vason. Tetos me ironi*) Buona note, sinjora!\*

*GABRIELI* — (*Duke i vënë grykën e revolverit mbas krahësh Vasos*)

Avanti!\*\* (*I arrestuari e shikon rrëptë. Ai e shtyn. Fillojnë të ecin.*)

*BESA* — Vaso!

*TETOJA* — Vasil, bir! (*Vasoja e ndal hapin edhe një herë para se të kapërcejë prakun e derës.*)

*VASOJA* — Mbahu, nënë! Lamtumirë, kushërirë!

*TETOJA* — (*Me qëndrim burrëror.*) Bir!

*GABRIELI* — (*Me nervozizëm*) Avanti! Avanti! (*E shtyn.*)

*BESA* — (*Gabrielit.*) Egërsirë! (*Dalin*)

*ANXHELO* — Tani kjo shtëpi do të flejë e qetë, sinjora! (*Cinik*) Buona note! (*Del. Tetoja e Besa që nga praku i derës*)

*BESA* — Vaso! Vaso!

*TETOJA* — Vasiil!

### Bie perdja

\*) Natën e mirë, zonjë.

\*\*) Përpara!

## PJESA E DYTE

Zyra e kapiten Anxhelos. Hyn Gabrieli.

**ANXHELO** — (Ngrihet e del nga tavolina) E, Gabriel, si vete puna me avokat Dollanaj?

**GABRIELI** — Ngurron, zotëri. Edhe pardje, duke bise-duar si zakonisht, i fyter më tha: «Duhet ta dini se keni të bëni me një intelektual e marksist të një tjetër kategorie, marshall Gabriel!»

**ANXHELO** — (Cinik.) Ha, ha, ha! Sidoqoftë mos ia merrni pér ters. Propaganda e kësaj kategorie marksistësh na ka shërbyer mjaft në këtë qytet punëtorësh. Kjo ka qenë edhe arsyefa që i kemi parë me simpati e s'i kemi prekur gjer më sot, Gabriel.

**GABRIELI** — Ju keni të drejtë. Propaganda e tyre vërtet na ka shërbyer, kapiten. Megjithatë, ndërmjet avokat Dollanajt e inxhinier Gjinajt ka një farë diferencë. Disi ndryshe u lidh ai tjetri me ne.

**ANXHELO** — Rrugët e atrimit kurrë s'mund të jenë të njëjta, mik Gabriel... Laze Gjinajn e afroi dëshpërimi lidhur me shpartallimin e të ashtuquajturit grup komunist të «Zjarrit», si dhe urrejtja pér Partinë Komuniste Shqiptare që ia rrëmbeu shokët, duke e shkatërruar nga themelat atë grup të tyre.

**GABRIELI** — Po. Kjo është e vërtetë.

**ANXHELO** — Dhe tani, ai ka vetëm një dëshirë: të hakmerret.

**GABRIELI** — Po a di gjë avokat Dollanaj se inxhinier Gjinaj prej kohësh punon edhe pér ne?

**ANXHELO** — S'ka rëndësi, mik Gabriel. Në qoftë se

nuk e di, ka për ta mësuar. Sidoqoftë Tel Andonin e kemi dhuratë prej të dyve, e tanë edhe Teno Gorenin.

*GABRIELI* — E kuptoj, kapiten. Megjithatë, ky tjetri, siç ju thashë...

*ANXHELO* — Mos u shqetësoni. Tagjia dhe kashaisja këtë kategori marksistësh e sjellin shpejt në binarë. Më kuptoni besoj?

*GABRIELI* — Ju kuptoj, kapiten. Ju me mua gjithnjë keni folur qartë.

*ANXHELO* — Këtë sqarim ia bëra sot në mëngjes edhe marshall Bertolini, por ai më tha se edhe ju i kishit folur për këtë lloj trajtimi.

*GABRIELI* — Sipas porosisë suaj.

*ANXHELO* — Sidoqoftë, jua theksoj, askush nga tanët s'duhet të dijë gjë rrëth tij e askush të mos marrë kontakt me të!

*GABRIELI* — Askush kapiten. Askush nuk hyn në qelinë e tij përvèç meje e Bertolini që merremi me të direkt. Bile edhe ushqimin ne të dy ia kemi çuar gjithmonë. Këtu të gjithë kujtojnë se ai po torturohet seriozisht.

*ANXHELO* — Kjo është edhe garancia e suksesit. Avokat Dollanaj nuk është për ne inxhinier Gjinaj. Ndërsa nga i dyti kënaqemi me ndonjë kurban të rastit që na sjell, nga ky tjetri, me legjendën që i krijuam dhe kredinë që gjëzon, presim që, duke hyrë në gjirin e Metush Metëve të depërtojë deri në sferat më të larta të Partisë së tyre. Dhe Kolë Dollanaj me dinakërinë e aftësinë që ka është në gjendje ta arrijë këtë objektiv të dëshiruar nga ne.

*GABRIELI* — Ju kuptoj.

*ANXHELO* — Kështu, prej tij presim, jo kapjen e një komunisti të veçuar, e bile jo vetëm zbulimin e kësaj organizate që vepron këtu, por edhe diçka më shumë në perspektivë. E kam fjalën për udhëheqjen e partisë së tyre, Gabriel. Ja pse ai duhet të mbetet i pazbuluar gjer në fund, duke u kujtar edhe nga tanët si një komunist i vendosur, të cilin për mungesë faktesh të mjaftueshme, u detyruam më në fund ta lironim pas një arreste e torture «të rëndë». Kjo që edhe arsyeva që e arrestuam Teno Gorenin,

me të dalë nga ajo mbledhje e tyre, sipas informatës që na solli inxhinier Gjinaj.

*GABRIELI* — Tani ju kuptoj edhe më mirë. Ju qëlloni larg, kapiten...

*ANXHELO* — Sidoqoftë, shikoni, a përfundoi Bertolini me të? Po të ketë përfunduar, sillmani menjëherë.

*GABRIELI* — Po, zotëri. (*Del.*)

*ANXHELO* — (*I mbetur vetëm, ngre receptorin e telefonit dhe formon numrin telefonik.*) Ugolin, e ke gati dosjen? (*Dëgjon përgjigjen e tij*) Mirë! Eja menjëherë! (*Ul receptorin. Mbas pak hyn Ugolini. Njerën anë të fytyrës e ka të nxirë. Anxhelo e shikon me habi.*) Ç'është ajo shembje, miku im?!

*UGOLINI* — Ai përbindëshi, zotëri. Vaso Gjika! Më qëlloi kur po e torturonim. Tamëm siç ju goditi edhe juve atë natën e arrestimit. (*Psherëtin*) Ka të drejtë marshall Gabrieli kur thotë: «I vogël, po gjarpër!»

*ANXHELO* — Si, more, si?! Gjer këtu arrin guximi i këtij çunaku të marrë?

*UGOLINI* — Ai është i ndërkryer, zotëri. Edhe fjalën e ka më therëse se thika dhe më farmak se helmi. Shfryn hapët.

*ANXHELO* — (*I nxehur.*) Racë djajsh! (*Merr dosjen nga Ugolini dhe e vë përrpara. U hedh nga një sy shkresave dhe i firmos me radhë.*) Coja menjëherë zëvendëskuestorit, Ugolin! (*Shikon orën.*) Ai i priste qysh një orë më parë!

*UGOLINI* — Po, zotëri. (*Gatitet në shenjë nderimi dhe del. Hyjnë Gabrieli dhe Kola. Gabrieli me një dosje në dorë, Kolës i duket në fytyrë shenja e një goditjeje.*)

*ANXHELO* — (*Duke u ngritur nga tavolina, i jep dorën me përzemërsi.*) Besomëni, ju shpreh keqardhjen time të sinqertë, zoti Dollanaj. Uluni!

*KOLA* — (*Duke u ulur.*) S'besoj se e meritoj një trajtim të tillë, zotëri!

*GABRIELI* — (*Kapitenit.*) Unë e kritikova marshall Bertolinin, por dhe zoti Dollanaj duhej të ishte treguar disi më i arsyeshëm. Për 22 ditë me radhë pavarësisht nga legjenda rreth një torture «të rëndë» që po i bëhej prej nesh, në fakt askush s'e kishte prekur me dorë. Sot, për fat të

keq, ndodhi ajo që s'duhej të kishte ndodhur! Me ta marrë vesh, siç e pa dhe vetë zotërija, unë shkova menjëherë për ta ndërprerë atë praktikë ndaj tij. Megjithatë, s'dua të zvogëloj këtu edhe meritën e zotit Dollanaj, i cili, pas asaj praktike të padëshiruar, s'ngurroi për një bashkëpunim sa më të koordinuar midis nesh dhe tij. (*Hap dosjen e nxjerr një shkresë*).

**ANXHELO** — (*Serioz*) E firmosur?

**GABRIELI** — Po. Ramë dakord siç e kishit parashikuar ju kapiten...

**ANXHELO** — Gëzohem shumë, zoti Dollanaj. Ne e kemi ndjekur me simpati luftën tuaj të gjertanishme në këtë kantier e në këtë qytet.

**KOLA** — Kurse unë jo vetëm s'e kisha parashikuar kurrë një trajtim të tillë, por as edhe një mbarim të tillë, kapiten.

**ANXHELO** — Ju s'jeni inxhinier Gjinaj, zoti Dollanaj, po një personalitet tjeter i nderuar, nga i cili tuajt dhe tanët presin shumë. Për punën që do të bëni dhe mënyrën se si do të vepron, do të bisedojmë me hollësi. Kjo, gjer në varr, duhet të mbetet midis meje, jush dhe Gabrielit. Puna që kemi bërë gjer më tani i ka të gjitha shanset për arritjen e objektivit që mendojmë. Juve, nga e papritura, me siguri do t'ju ketë ardhur keq për atë arrestim tek pinjt me shokët tuaj. E sidomos për atë goditjen nga njerëzit tanë në një vend publik siç është kafja. Por ai veprim, megjithëse i pahijshëm e i padëshirueshëm nga të dy palët, pas asaj disfate me Teno Gorenin ishte i vetmi mjet që mund t'i shërbente qëllimit tonë të përbashkët. Që prej atij çasti ju jeni rritur jashtë masës përpara syve të këtij qyteti punëtorësh. E sidomos tani, pas historisë së kësaj legjende.

**KOLA** — E kuptoj kapiten, veçse jua thashë edhe më parë, kurrë nuk e përfytyroja se rruga ku kam ecur do ta kishte fundin këtu.

**ANXHELO** — Lufta kundër të njëjtit armik patjetër një ditë do të na gjente në të njëjtën barrikadë. Megjithëse ne kemi kohë që jemi në të njëjtën barrikadë, avokat. Kjo ka qenë edhe arsyefa që, me gjithë deklaratat tuaja për

komunizmin, nuk ju kemi prekur gjer më sot e nuk do t'ju prekim as edhe në të ardhmen. Bile, s'ju prekëm si grup, as kur dolët e morët fjalën edhe në atë demonstratë... E, as kur ju, si avokat, i keni marrë në mbrojtje të aku-zuarit politikë, duke mbajtur ligjërata të bujshme në favor të tyre. Bile, herë-herë, ta themi midis nesh, na keni vënë edhe në pozitë të vështirë. Megjithatë, ne kemi heshtur, zoti Dollanaj.

KOLA — E kuptoj, kapiten... (*Hyn Ugolini.*)

UGOLINI — (*Anxhelos.*) Zotëri, zëvendëskuestori ju kërkon pak.

ANXHELO — Ashtu? (*Kolës dhe Gabrielit*) Po kthehem menjëherë. (*Del. Mbas tij edhe Ugolini.*)

GABRIELI — (*Ugolinit që posa ka dalë.*) Ugolin! Ugolin! (*Shpejton drejt derës.*)

UGOLINI — (*Që jashtë*) Urdhëroni, marshall Gabriel! (*Kthehet. Po Gabrieli ka arritur te pragu. Ndalen aty. Në intimitet, ai diçka e porosit Ugolinin që ndodhet tej pragut të derës. Gabrielit i duket vetëm shpina. Kola mbetet vetëm.*)

KOLA — (*Ngrihet nga kolktiku. I menduar.*) E mori dreqi, e mori! Kurrë s'e kisha menduar kështu... Po, si tha? Si tha? «Ne kemi kohë që gjendemi në të njëjtën barikadë?» Po. Disi i kam ndihmuar, por jo me qëllim për të arritur gjer këtu. (*I shqetësuar.*) Me siguri do të ketë edhe njérëz që do ta gjykojnë këtë lloj pranimi nga ana ime si tradhti... Po tradhti është kjo?! Unë... (*Mendohet*) mund të kisha zgjedhur edhe ndonjë rrugë tjetër, xhanëm, po edhe kjo që zgjodha qëllimit të grupit tonë i shërben. Tek e fundit, ç'janë duke bërë Sadiku e Anastasi? Ata vetë e thonë: arritura e objektivit justifikon përdorimin e cilitdo mjeti! Kush mund të thotë se unë s'e dua këtë vend? Kush mund të thotë se... Po edhe murit, ama, nuk i bihet me kokë! Megjithatë, unë do të di sa dhe si... (*Hyn Anxhelo. Ugolini largohet.*)

ANXHELO — Do t'ju kërkoj ndjesë, zoti Dollanaj. Na duhet ta ndërpresim bisedën. Megjithatë, ne biseduam dhe ramë dakord në përgjithësi. Përsa i takon hollësirave të veprimit të mëvonshëm, siç ju thashë, do të bisedojmë

sot mbasdite, para daljes suaj që këtej. Pra, mirupafshim dhe suksese në misionin tuaj të së ardhmes!

**KOLA** — Mirë të shihemi, kapiten! (*I jep dorën.*)

**ANXHELO** — (*Gabrielit*) Përcille zotin Dollanaj dhe ktheu sa më shpejt!

**GABRIELI** — *Sinjor-si!*\* (*Dalin Gabrieli dhe Kola.*)

**ANXHELO** — (*Në pritje të Gabrielit. Baret i gëzuar nëpër zyrë. Hyn Gabrieli.*). Ndoshta ky Kalë Troje do të na vlejnë shumë herë më tepër se gjithë ky tabor që kemi këtu përreth. E vtmja rrugë pér t'i hyrë brenda kësaj kështjelle që s'duket gjékund me sy e që s'di me çfarë forcash ta rrethosh e ta nënshtrosh ...

**GABRIELI** — Edhe kur i ke në duar, ata të torturojnë me heshtjen e tyre të pafund, kapiten. S'do ta harroj kurrë si e kam ndier veten para atyre të dyve që kufizojnë me birucën e avokat Dollanajt. E kam fjalën pér ata dy të ardhurit nga Tirana, Alqi Kondin dhe Hajdar Dushin, që mendohet të janë të dërguar nga qendra.

**ANXHELO** — Pse, q'gjë e veçantë të ndodhi me ta?

**GABRIELI** — 26 ditë tortura, kapiten dhe asnje «ah» nga goja e tyre! Më tërboi ajo heshtje, gjersa një ditë e humba durimin. Duart dhe mjekra filluan të më dridheshin njëherësh. Po merresha me atë më të riun në ato çaste. «Kam nevojë që të dëgjoj njëherë t'ia bësh «ah» Alqi Kondi, dhe po të lëshoj!» — i thashë. Po a e dini si m'u përgjigj, zotëri? «Atë kënaqësi s'kam pér të ta dhënë kurrë, marshall Gabriel!» — dhe më pështyu në fytyrë.

**ANXHELO** — Enigmë, miku im. Dreqi e di nga e marrin gjithë këtë forcë pér qëndresën? (*Befas ndihen pushkë në thellësi. Të dy, të shqetësuar, mbajnë vesh.*) Po këto ç'të janë?

**GABRIELI** — S'di ç'të them, kapiten. Ndoshta tanët ndjekin ndonjë prej tyre. Megjithatë, ky qytet, dikur aq i qetë, është bërë tanë qyteti i vdekjes e i flakëve. Po vrasha e të ndjerit kuestor Sirakuza qe grushti më i tmerrshëm që na kanë dhënë gjer më tanë.

---

\* ) Po, zotni.

**ANXHELO** — (Psherëtin.) Veç le ta dinë: mua më quajnë Anxhelo Andreoti, Gabriel! Nëpërmjet avokat Dllanajt, një ditë...

**GABRIELI** — Megjithatë, këto net me barrë dreqi e di ç'do të na pjellin përsëri, kapiten!

**ANXHELO** — (Psherëtin.) Po, Gabriel, dreqi e di! S'më hiqen nga mendtë fjalët që i kishin thënë të paharruarit kuestor kur e kishin qëlluar: «Në emër të atyre që doni të çoni në internim, kuestor Sirakuza! Në emër të tanëve që nga Mujua e gjer tek ai që arrestuat tri javë më parë.» Po kush është ky Mujua i tyre, që s'po më kujtohet ndër të arrestuarit a ndër të dyshimtët tanë?

**GABRIELI** — Mujo Ulqinaku, kapiten. I pari ndër lutfetarët e tyre që ra më 7 prill 1939.

**ANXHELO** — Ahaaa! E qartë, Gabriel, e qartë. Të vdekurit po na dëmtojnë njëloj si të gjallët.

**GABRIELI** — Edhe më fort, kapiten. Rreshter Ugolinit tani edhe gjumi i del me llahtarë nga frika e tyre. E kam fjalën për të vdekurit...

**ANXHELO** — Nëse është kështu, ai duhet qërtuar, mik Gabriel! Ky do të ishte një fund me tmerr!

**GABRIELI** — E qërtova, po a e dini si m'u përgjigj? «Më mirë një fund me tmerr, se sa një tmerr pa fund, marshall Gabriel!»

**ANXHELO** — (Mendohet.) Traumë! Traumë nervore, Gabriel! Veçse një gjë s'arrij të kuptoj: vrasin, po si s'u kap njëherë ndonjë prej tyre?

**GABRIELI** — Pikërisht, kjo po më çmend, zotëri.

**ANXHELO** — Po na çmendin, thuaj, Gabriel! Ja edhe letra që i kishin lënë mbi trup të ndjerit kuestor: «Morëm vesh transferimin tuaj për në Itali. Po njësiti ynë guerril, lidhur me shërbimet që i keni sjellë popullit shqiptar që nga 7 prill 1939 e këtej, vendosi t'ju strehojë përgjithmonë këtu!»

**GABRIELI** — Kanë udhëheqje të fortë, kapiten. Lufta me ta s'qenka punë e thjeshtë sic e patëm kujtar në fillim.

**ANXHELO** — Prandaj punës për ta marrë kështjellën nga brenda, në këto kushte të vështira, duhet t'i kushtojmë edhe më shumë kujdes.

*GABRIELI* — Bindem, zotéri. Keni plotësish të drejtë.

*ANXHELO* — Edhe një pyetje: Po me Teno Gorenin, c'mendoni se duhet të bëjmë? E kam fjalën pér sekretin, Gabriel.

*GABRIELI* — (*Mendohet*) Ventotenia do tē ishte ilaçi i kësaj pune, kapiten. Internimi në Ventotene.

*ANXHELO* — Jo, mik Gabriel. Në asnjë mënyrë. Ai duhet tē mbarojë në këto qeli! Gojët i kyç vetëm varri...

*GABRIELI* — (*Pohon me kokë*.) Ashtu, ashtu, Keni tē drejtë. Gojët i kyç vetëm varri.

*ANXHELO* — Pra, po e myllim këtë seancë. Unë po kaloj matanë. Zëvëndës kuestori... (*Bën tē dalë. Ndalet*.) Edhe një porosi: pres tē më relاتoni pér atë që arrestuat mbrëmë. E kam fjalën pér Sotir Isaun, mik Gabriel.

*GABRIELI* — Sinjor-si! (*Dalin. Bie perdja*.)

(Në paraskenë Laze Gjinaj.)

*LAZJA* — (*I vetëm*.) Megjithëse njeri i guximit, kohët e fundit, me sa kam vënë re, po mundohet tē më lárghet sa më shumë. Kam përshtypjen se është penduar... Po tanë ai pendim s'i pi më ujë. (*Mendohet*). Sidoqoftë, pér tē dhënët e tij në këto ditë kam shumë nevojë. Do tē më shohë se si do t'ia shtrëngoj burgjitet... (Në këndin tjetër tē paraske-nës duket Mentor Dakaj. Lazja, me mospërfillje e përgjimim): Afrohu, Mentor Dakaj, afrohu!

*MENTORI* — Po ç'është kjo këmbëngulje pér takim, xhanëm? Të vësh në rrezik kokën e tjetrit s'është shenjë e mirë e as punë e ndershme. Ti e di se unë...

*LAZJA* — (*Cinik*.) Ndershëmérinë kjo botë ka kohë që e ka nxjerrë jashtë ligjit. Thirrja është: «Të pushkatohet kudo që tē shihet!» E trembur, ajo është hedhur në ilegalitet. Thonë, tanë strehohet vetëm nëpër shtëpitë publike, qyteteve. Pra, mblidh veten e fol pa frikë!

*MENTORI* — Kurrë s'e mendoja një gjë tē tillë! Ç'sjellje e ndyrë!

*LAZJA* — Ndoshta! Po pse kjo hije tē vdekuri në ftyrë? (*Nxjerr një pasqyrë xhepi dhe ia vë përballë*).

*MENTORI* — (*I fyter. Me nervozizëm*.) S'ka nevojë (Ja

*shtyn dorën me përbuzje.)* Po, me sa duket, paske harruar se unë jam i përjashtuar nga partia e vazhdimisht nën mbiqyrje të tyre.

**LAZJA** — Megjithatë, një këmbë akoma ta kanë lënë brenda, duke të mbajtur në grupet e simpatizantëve të tyre. (*Me ironi.*) Pra, me sa shihet, akoma kanë shpresë të të edukojnë! (*E kap për krahësh dhe e shkund me kanosje.*) Fol! Ndonjë informatë. . . Ç'të ka zënë veshi?

**MENTORI** — Po grupi juaj u shkri. . . Për cilët tani të duhet kjo informatë?

**LAZJA** — (*Me përcëmim*) Fol, fol, atë shiko ti!

**MENTORI** — (*I tronditür.*) I poshtër. Nga një farë pakënaqësie ndaj partisë, të shërbeva pa vetëdije, duke të dhënë gishtin, kurse tani po kuptoj se ti po mundohesh të më marrësh krahun edhe kokën!

**LAZJA** — Ndoshta. Po tani e ke të pamundur të më bësh bisht, Mentor Dakaj. (*Nxjerr një letér.*) Ky është një dokument që mund të të kushtonte jetën. Metush Meta s'do të ta falte kurrë. Besoj i njeh shkrimin dhe firmën tënde. Do t'i shikosh? Dhe mos harro se, për këtë qëllim, të sollëm nga Berati e të gjetëm punë. Hëpërhë, këtu je i vetëm nga tanët që mund të depërtosh ndër ta. (*Mentori i dërrmuar moralisht, hesht.*) Ç'ke që t'u ngjit gjuha për qiellze? Apo drithma e vdekjes?

**MENTORI** — Jo. Veç mos kujto se e kam aq të lehtë. Ndërmjet tyre është vetëm një që njoh e që më beson gjer në një farë shkalle.

**LAZJA** — Nejse! Qoftë edhe nëpërmjet tij, fol, ç'ke dëgjuar! Ja, për shembull, kush i bëhet strehë këtu ilegalit Metush Meta?

**MENTORI** — As di, as kam dëgjuar se kush.

**LAZJA** — Po atëherë ç'di ti? (*Me kërcënim.*) Mos harro se heshtja...

**MENTORI** — (*I tronditür. Mendohet. Pauzë e shkurtër.*) S'di sa është e vërtetë, po, siç më zuri veshi, sonte më duket do të sulmohet depoja e munitioneve në Kuçovën e Vjetër...

*LAZJA* — Sonte the?! (*Entuziazt.*) E mrekullueshme! Rast me të vërtetë i bukur. Ndoshta me ta do të jetë edhe vetë Metush Meta. Ata që merren me këto punë s'do të ta harrojnë kurrë këtë shërbim. Kurrë!

*MENTORI* — (*I zbetë.*) Oh! Sa i tronditur që jam!

*LAZJA* — I marrë! Rëndësi ka shërbimi që po sjell. (*Cinik.*) Hajt, tani, mbathja! (*Largohet me të shpejtë.*)

*MENTORI* — (*I vetëm me tronditje.*) I poshtri! Oh, në çfarë kurthesh e futa veten unë! (*Del i trishtuar.*)

(*Hapet sipari. Skena në shtëpinë e teto Katinës. Metushi i shtrirë mbi nim, dremit. Teto Katina bën stivë një grumbull traktesh, i mbledh në një bohçe dhe pastaj, ngadalë i afrohet fotografisë së Vasos të varur në mur.*)

*TETOJA* — M'u ndave, bir! Po nëna, gjer në fund s'do t'i ndahet rrugës sate. Këto fletë, (*Tregon bohçen e mbushur me trakte.*) do të ndezin flakë qindra e qindra zemra në këtë qytet punëtorësh, ku dikur punoje dhe ti vetë! (*Del. Hyn Besa.*)

*BESA* — E gjora! Sa grua e fortë që është! (*Hedh shikimin nga Metushi. Afrohet dhe e mbulon me një batanije. Vështrimi i saj iëmbël shpreh hapët dashurinë që ka për të. Metushit me zë të ulët.*) E di! Ti kujton se s'të dua, po prit, prit njëherë sa të mbarojë kjo luftë. . . (*E pret fjalën. Metushi duke u zgjuar.*)

*METUSHI* — Më bënë veshët, apo vërtet po flisje me njeri?

*BESA* — (*E emocionuar.*) Me asnjeri. (*Hesht dhe mendohet.*)

*METUSHI* — (*Duke u ngritur.*) Përse mendohesh? Apo ndoshta ndonjë lajm të ri?

*BESA* — Jo. Asgjë të re nuk ka, po arrestimi i Vasos dhe shkëputja e Asimit, siç e di. . . (*Psherëtin.*)

*METUSHI* — (*Pauzë.*) E kujt s'iu dhimsën ata, Besë? (*Pauzë e gjatë.*) Po teto Katina ku është?

*BESA* — Qëkurse arrestuan Vasilin, s'pyet më për asgjë. «Përse do ruhem, — më tha, — vete unë t'i shpërndaj». Dhe m'i rrëmbeu traktet nga duart.

*METUSHI* — E shkreta grua! Po, a qan ndonjëherë?

**BESA** — Jo. Unë, duke vështruar fotografinë e tij, u përlota, por ajo m'u zemërua: «Mos, — më tha, — e kam amanet nga djali, asnjë lot në shtëpinë e tij, moj bijë!»

**METUSHI** — (Mban vesh.) M'u duk, apo vërtet dëgohen këmbë? (Besa del të shikojë.)

**BESA** — (Duke u kthyer buzagaze) Irena dhe Mehmeti. (Largoher. Hyjnë Irena dhe Mehmeti.)

**ZËRA** — Vdekje fashizmit!

**METUSHI** — Liri Popullit! (Ngrihet, iu jep dorën) Edhe një sihariq! Përpjekja e armikut për t'i internuar të arrestuarit politikë dështoi përfundimisht.

**MEHMETI** — E dëgjova. Fitore e madhe, Metush.

**METUSHI** — Kur ngrihet populli në këmbë, s'ka forcë që e kthen pas!

**MEHMETI** — Ashtu vërtet...

**METUSHI** — (Irenës) E tani a e dini pse ju thirra?

**IRENA** — Jo.

**METUSHI** — Për Asimin, Irenë. Shpesh më rri mendja tek ai.

**IRENA** — Unë jam lënduar nga qëndrimi i tij, Metush, e gjer më sot vetëm dy herë e kam takuar, megjithëse mendjen tek ai e kam pasur.

**METUSHI** — Vetëm dy herë në tri javë? Keq. Shumë keq. Ky s'është qëndrim i drejtë. Ne Asimin duhet ta kuptojmë siç është. E po ashtu, të bëjmë përpjekje të gjithë së bashku për ta shpëtuar.

**IRENA** — Ai do të bënte mirë ta kuptonte këtë gabim të rëndë e të kërkonte ndjesë...

**METUSHI** — Ai kujton se mbron një çështje të drejtë, Irenë!

**MEHMETI** — Dhe pikërisht kjo është edhe fatkeqësia e tij.

**METUSHI** — Po, kjo është edhe arsyaja që shokëve u vjen keq për të. A e dini se ku kishte shkuar nëpër natë që atë çast që u nda prej nesh? Fill e në Berat për të takuar Sekretarin Politik të Qarkorit të Partisë. Po s'e kishte gjetur. Shoku Bari prej ditësh ndodhet në Skrapar për disa probleme që kanë dalë në çetën Plakë. Megjithatë, ai be-

son se, kur të kthehet Bariu, çështja menjëherë do të zgjidhet në favor të tij e të Kolë Dollanajt!

*MEHMETI* — Sa keq që e ka një bindje të tillë!

*METUSHI* — Megjithatë, Asim Zagora na përket neve. Ky është edhe mendimi i Qarkorit të Partisë. Prandaj, shpëtimi i tij është detyrë për secilin nga ne si komunistë.

*MEHMETI* — Ashtu vërtet.

*METUSHI* — Po që t'ia arrijmë këtij qëllimi, me të duhet durim e punë. Sidoqoftë, koha punon për ne dhe ajo do ta bindë edhe Asim Zagorën.

*MEHMETI* — Me siguri!

*METUSHI* — Edhe diçka tjetër: Qarkori, në kundërshtim me mendimin e Çelikut për përjashtim, mbështeti propozimin e shumicës së organizatës, të mos shpejtohemë në marrjen e një vendimi të tillë, po të bëhen të gjitha përpjekjet për ta bindur, që të kthehet midis shokëve. Dhe kjo, edhe njëherë, tregon hapët, Irenë, se shokët e duan dhe e çmojnë atë. Bile, edhe Çeliku, që ka mbajtur e mban një qëndrim më të prerë se të tjerët, nuk e do më pak.

*IRENA* — Për këtë jam e bindur. Po edhe ai nuk i do më pak shokët, Metush.

*MEHMETI* — Ai ka vetëm një dobësi, Irenë. Megjithëse atyre, si grup, ka kohë që u ka kthyer krahët, nga Kola, shpirtërisht akoma nuk është ndarë.

*METUSHI* — Kjo është edhe arsyaja që e kemi shtyrë pranimin e tij në parti.

*MEHMETI* — Ai nuk i kupton dredhitë, Metush.

*METUSHI* — Ashtu është. Po s'e pa të keqen me sy, e ka të vështirë të besojë ...

*IRENA* — Po. Po s'e pa me sy...

*MEHMETI* — Poet.. Poet dhe mësues, Irenë! Rron në botën e poezisë dhe të fëmijëve. Sidoqoftë, ti, si shoqja e tij më e afërt, duhet të luftosh për ta bindur se vendimi i shokëve është i drejtë.

*METUSHI* — Pikërisht për këtë qëllim organizata ka menduar që këtë detyrë të ta ngarkojë kryesisht ty, e pastaj edhe Mehmetit. Do të shkoni bashkë për ta takuar. Kam biseduar me Mehmetin.

**IRENA** — Gëzohem që Partia e shikon me këtë sy qëndrimin e tij. Unë do të bëj çmos, megjithëqë për arrestimin dhe torturat që flitet se po i bëjnë Kolës, do ta kem të vështirë t'i kundërvihem.

**METUSHI** — E di, Irenë. Megjithatë, thuaj se Partia e ka pezulluar hëpërë vendimin e marrë e po heton me urtësi rrëth këtij arrestimi. Më kupton, besoj...

**IRENA** — Të kuptoj, Metush. Po s'di sa do të mund të bindet ai nga fjalët e mia.

**METUSHI** — Sidoqoftë, si ti ashtu dhe Mehmeti, kujdes, të mos e cënoni në asnje mënyrë. Në këto çaste, e sidomos pas legjendës për «torturat» që po i bëjnë Kolë Dollanajt, ai e ka edhe më të vështirë të besojë në drejtësinë e vendimit tonë. Dhe kjo legjendë, ta themi hapët, ka huftar edhe mjaft të tjerë në këtë kantier e në këtë qytet, duke përfshirë edhe ndonjë nga komunistët tanë. Bile, edhe njeriun tonë të brendshëm në kuesturë. Ai thotë se edhe atje flitet se po e torturojnë rëndë. Po me sy,asnje nga personeli shqiptar nuk e ka parë. Thuhet se në pyetje e në tortura e marrin vetëm të dy marshallët Gabrieli e Bertolini. Megjithëkëtë, njeriu ynë atje po heton vazhdimisht. Kjo është e vërteta. Pra, me takt, Irenë!

**IRENA** — S'do të lë gjë mangut, Metush.

**MEHMETI** — Gjithashtu edhe unë. Megjithëse më vjen keq që në aksionin e sontshëm nuk do të mundem të marr pjesë.

**METUSHI** — Ky juaji është një aksion shumë më i rëndësishëm, Mehmet. Pra, mirupafshim dhe ardhshi me lajme të mira!

**IRENA** — Mirupafshim dhe faleminderit, Metush!

**MEHMETI** — Mirupafshim! (*Dalin. Hyn Besa.*)

**BESA** — Gjergj Golemi kërkon të të takojë.

**METUSHI** — Gjergji? Le të hyjë! (*Besa del. Hyn Gjergji.*)

**GJERGJI** — Erdha sipas thirrjes sate.

**METUSHI** — Mirë se erdhe e gëzohem që po shihemi përsëri. (*I shtrëngon dorën.*)

**GJERGJI** — Me këtë rast dua edhe të të falenderoj.

Kam rilindur, Metush! Unë tani po e kuptoj se në çfarë bataku paskësha rënë!

*METUSHI* — Shqiponjat e kanë folenë ndër male, Gjergj, kurse bretkosat në kënetë. Po Anastas Lulët e Kolë Dollanajt s'janë vetëm bretkosa po edhe gjërpinj.

*GJERGJI* — I njoha mirë.

*METUSHI* — Po pa më fol njëherë: si e ndien veten midis shokëve të tu të rinj?

*GJERGJI* — Si jo më mirë! Unë tani gjeta me të vërtetë shokët!

*METUSHI* — Po nga puna, a ke filluar ndopak?

*GJERGJI* — Po. Çeliku më ngarkoi detyrën të udhëheq grupin e sabotazhit të naftës në rrötën Nr. 24. Ju fallem nderit për besimin. Aksion i mrekullueshëm. Një e treta e naftës i mbetet nëntokës sonë çdo ditë.

*METUSHI* — Goditje e tmerrshme për okupatorin, Gjergj. Pa naftën, lufta e tij nuk ecën.

*GJERGJI* — Ashtu vërtet. U bënë muaj që kontrollorët italianë s'po dinë nga t'ia mbajnë nëpër kantier. (*Pauzë. Metushi mendohet.*) Përse mendohesh?

*METUSHI* — Po me Asim Zagorën a të bie rasti të shihesh ngandonjëherë.

*GJERGJI* — Me Asimin? Pothuaj për ditë!... Si gjithnjë midis nxënësve, Metush. Do të thosha, rrallë ka mësues që t'u kushtohet të vegjelëve në atë mënyrë!

*METUSHI* — Ashtu është. Ai i do shumë fëmijët.

*GJERGJI* — Edhe pardje në mbledhjen e grupit edukativ erdhi më mori e shkuam bashkë. Po s'di pse m'u duk aq i vrarë! Bile ka ditë që më është dukur ashtu. Pastaj në bisedë, jashtë...

*METUSHI* — Çfarë në bisedë?

*GJERGJI* — Desha të thosha, sa i përmenda Vason që po e torturojnë, pshëretiu e u përlot menjëherë. «E kam pikë në zemër atë djalë!» — më tha. Pastaj shfryu kundër një kapiteni të kuesturës.

*METUSHI* — Po. Ai e ka dashur shumë Vason e vogël. (*Mendohet*) Edhe një pyetje, Gjergj. A merr pjesë në rregull në mbledhjet tuaja të grupit?

*GJERGJI* — Gjithmonë. Bile diskuton e përherë me

detyra të kryera më mirë se kushdo tjetër nga ne. Veçse, siç të thashë, kohët e fundit nuk shoh në sytë e tij atë gjëzimin e mëparshëm... Ndoshta shkaku i Vasos, siç të thashë... (*Metushi rrudhet në fytyrë.*)

*METUSHI* — Ndoshta edhe ai shkak... (*Përsëri i menduar. I hedh dorën mbi sup.*). Tani të vijmë te çështja jote. Shokët, duke e çmuar punën e vendosmërinë tënde, kanë propozuar të bësh pjesë në njësitin guerril. Si të duket ky propozim i tyre?

*GJERGJI* — (*I emocionuar.*) Unë? Po a e meritoj këtë nder?

*METUSHI* — Ti je proletar, Gjergj. Dhe vija e parë u takon atyre. Apo s'është kështu?

*GJERGJI* — Ke të drejtë. Po mua akoma s'di pse po më duken si èndërr këto fjalë! Sidoqoftë, ju premtoj shokëve se s'do ta harroj kurrë këtë çast dhe këtë nder.

*METUSHI* — Ja, për këtë të thirra. Vargu i aksioneve tona ka për të qenë i gjatë. Pra, mirupafshim!

*GJERGJI* — Mirupafshim, Metush! (*I jep dorën. Del duke nderuar me grusht. Hyn Tafili.*)

*TAFILI* — Kapiteni Anxhelo u gjet i vrarë.

*METUSHI* — (*Me habi*) I vrarë?! Po nga kush? Apo mos vallë... ?! (*Erren dritat, skena në shtëpinë e Asim Zgorës. Asimi i ulur pranë tavolinës me një libër të myllur ndër duar. Kokulur rri e mendohet. Heshtje e gjatë. Ndërkohë hyn proletari e komunisti veteran Thanas Verria.*)

*THANASI* — Asim! Mora vesh që gjëndeshe në shtëpi dhe erdha. Po përse larg shokëve e i menduar?

*ASIMI* — (*Ngrihet me një ndjenjë respekti. Me shqetësim.*) Kot, kot, xha Thanas. As unë vetë s'di përse po mendohesha. Po qenkeni kthyer nga Patosi?

*THANASI* — Po, bir, po. Qysh 5 ditë më parë. Dy javë e kusur atje. Veç më habitë e më lëndoju çështja jote. Shokët më treguan se për shkak të Kolë Dollanajt ti je prishur me ta. A s'është tamam kështu siç ma treguan ata dhe siç dëgjova edhe në popull?

*ASIMI* — Shokët?! Kush nga shokët ju paska folur për këtë çështje?

*THANASI* — Edhe Mehmeti e Irena që porsa ishin

ndarë tani prej teje. M'u dhims e shkreta vajzë. Sytë akoma i kishte me lot...

ASIMI — Jo. Unë s'jam prishur, po s'jam në një mendje me ta pér qëndrimin që duan të mbajnë ndaj Kolës. Këtë u thashë edhe Mehmetit e Irenës. Unë besoj se Partia do ta zgjidhë këtë çështje. Me siguri është vepër e ndonjë keqdashësi që e solli pünën gjer në këtë shkallë.

THANASI — Megjithatë, Asim, desha të të pyes mbas asaj që ngjau, a je menduar ndonjëherë se ç'do të thotë të largohesh nga shokët?

ASIMI — Njëherë thua? Njëqind herë, xha Thanas. Gjatë dy netëve të para nuk vura gjumë në sy. Irena e di mirë këtë të vërtetë. Në ato çaste një mendje më thosh: «Shko e kërkoju ndjesë! Ata janë të sigurtë, pa e morën atë vendim. Kolën me siguri kanë pér ta lëshuar brenda dy-tri ditëve!» Po ndodhi krejt e kundërta. Në vend që ta lironin, filluan torturat kundër tij.

THANASI — (Me keqardhje pér naivitetin, e tij.) Eh, Asim, Asim!

ASIMI — Megjithatë, edhe kur në qytet nisi të flitej se po e torturonin egër, e ai, si komunist, po u qëndronte me vendosmëri, unë prapëserapë ato lajme jam munduar t'i marr me rezervë. Po dy ditë më parë takova një njeri që i çon ushqimin pér çdo ditë. «Sot pér herë të parë më lanë ta shikoja, — më tha. — Vëç, ç'të të tregoj, e kishin bërë gjak, Asim.» Tani, më fort se kurrë, bindem se akuzat e Çelikut e të Metushit kundër tij janë të pathemelta.

THANASI — Po cili ishte ky njeri që e paska takuar?

ASIMI — Xhaxhai, siç e di, punon bahçevan në familjen e Dollanajve.

THANASI — Mos u fyej, po sikur ky arrestim e kjo torturë të jenë një manevër e armikut pér të arritur një synim të tij që neve mund të na kushtonte shtrenjtë?

ASIMI — Manevër? Eh, xha Thanas! Edhe Mehmetit kështu ia kishin mbushur mendjen që në fillim e s'pranonte se atë mund ta preknin me dorë. Po njerëzit e panë të përgjakur kur e arrestuan dhe tani, pér tri javë rresht, ai e di se c'po heq prej tyre. Merrmani si të doni, po mua

asgjë s'ma lëkund besimin që kam. Dita kur çështja e Kolë Dollanajt ka për t'u zgjidhur drejt e përfundimisht e unë përsëri do të jem midis shokëve të mi të njësitit, s'ka për të qenë e largët.

**THANASI** — Po në ç'mënyrë e mendon kthimin tënd, Asim?

**ASIMI** — Nëpërmjet Partisë, xha Thanas. Unë s'e kam lënë asnje çast në heshtje këtë punë. Fill mbas ndarjes, katër herë kam shkuar në Berat për të takuar Sekretarin Politik të Qarkorit. Po, për fat, ai ka shkuar në Skrapar për disa ngjarje në Çetën Plakë. Sidoqoftë, prapë do të shkoj e do ta kërkoj dhe çështja do të zgjidhet patjetër një ditë të afërt.

**THANASI** — Po sikur edhe Qarkori të thotë se Kolë Dollanaj është me faj dhe e meriton këtë dënim, q'do të bëje ti atëherë?

**ASIMI** — Partia është e urtë, xha Thanas. Ajo s'rrëm-behet nga pasionet, siç mund të rrëmbehet ndonjë prej nesh në ndonjë rast. Po prapë ja ku ta them: po të thotë Komiteti Qarkor i Partisë, Asim Zagora s'do të ngurrojë asnje çast, po do të vijë e do të ulë kokën para shokëve të vet. Por unë jam i bindur se Komiteti Qarkor s'ka për ta aprovuar kurrë atë vendim, sa të shpejtuar, aq edhe të padrejtë.

**THANASI** — Pra, ti s'je dakord që ata të ngrejnë dorën kundër tij?

**ASIMI** — S'jam. Jua thashë. Ai është njeri i nder-shëm dhe i drejtë si gjithë ne të tjerët. Ai e do Shqipërinë dhe komunizmin jo më pak se ata që e gjykuin dhe e ndëshkuin aq rëndë. Dhe këtë ai e ka provuar plotësisht.

**THANASI** — Në çfarë rastesh dhe në ç'mënyrë?

**ASIMI** — A s'është ai që qysh disa vjet më parë krijoj këtu një bërthamë komunistësh?

**THANASI** — Dhe c'bëri kjo bërthamë për disa vjet me radhë.

**ASIMI** — Ajo s'varej prej tij.

**THANASI** — Po që nga formimi i Partisë e këtej, kur tanët po luftojnë e derdhin gjak në çdo anë, ç'e ka penguar

që dhe ai të zinte vend e të luftonte përkrah të tjerëve?

**ASIMI** — S'e kanë lejuar, xha Thanas. Me udhëzim nga krerët e grupit të tij ka qenë i detyruar t'i qëndrojë larg luftës sonë.

**THANASI** — Luftës kundër armikut, Asim. Kurse tonës i ka qëndruar ballëpërballë, duke u renditur në të njëjtën llogore me armiqtë.

**ASIMI** — Si? Edhe ju gjykon kështu kundër tij?

**THANASI** — Dëgjomë, bir! Unë jam proletar e komunist i vjetër dhe i njoh mirë deviatorët trockistë. Kam qenë anëtar partie në Francë e në Meksikë. Atje edhe Trockin vetë kam pasur rast ta shihja si po të shoh ty tanë e ta dëgjoja në një bisedë me punëtorinë. Nga dukja e fjala i èmbël, kurse nga shpirti e qëllimet i zi si djalli. E atë dukje e ato qëllime, Asim, kanë edhe pjellët e tij, Sadik Premtet, Andrea Zisët e Kolë Dollanajt me shokë.

**ASIMI** — Duket që ju atë s'e njihni mirë, xha Thanas! Ai përgjërohet për të varfërit e punëtorinë.

**THANASI** — Përralla, more bir! Në dukje ashtu përgjërohej edhe Trocki vetë. Po me helmin që vjell kjo kategori grupazhësh kundër vijës dhe direktivave të Partisë, me përpjekjet që bën për të përçarë e larguar popullin nga lufta, pra, me rolin që lot për t'ia shtuar plagët vendit, duke ia zgjatur jetën okupatorit, e ka merituar me kohë një plumb kokës. E, në krye të këtij grapi këtu qëndron Kolë Dollanaj. Unë s'di pse shokët tregohen kaq të butë e kaq të gjerë ndaj tij!

— **ASIMI** — Më falni, po ju shpejtoheni e gaboheni rënëdë. Kokat e njerëzve s'janë topa lecke që mund të merren nëpër këmbë në këtë mënyrë.

**THANASI** — Të njerëzve jo, por të armiqve po! Dhe ja ku po ta them: ky është gjithmonë fundi i tradhtisë... dhe ky fund ka për të pritur edhe atë.

**ASIMI** — I tradhtisë?! Po a s'e patë ç'qëndrim mbajti në demonstratë? E pse të mos mendojmë se me këtë hap ai desh t'i hapte rrugën vetes drejt Partisë? Ashtu siç bëra dhe unë dikur...

**THANASI** — Kjo s'është Parti e grupazheve dhe devia-

torëve, Asim. Populli thotë: gjarpri nuk shtihet në gji, se të ha.

*ASIMI — Gjarpri?*

*THANASI — S'ka nevojë... E kuptoj, bir! E kuptoj! Ti ende ke nevojë për kohë. Ne do të takohemi prapë... Lam-tumirë! (Niset për të dalë.)*

*ASIMI — (Duke i prerë rrugën.) Jo! Ju lutem, prisni! Unë kam edhe argumete të tjerë. Ne e dënuam më vdekje, kurse kuestura e arrestoi dhe po e torturon rëndë. Bile në popull flitet...*

*THANASI — S'ka nevojë (Bën të dalë.)*

*ASIMI — Po daleni, ju lutem! Ju s'më thatë asnjë fjalë! Nuk është e drejtë të largoheni kështu...*

*THANASI — Të thashë! Ne do të takohemi përsëri! Lamtumirë! (Del.)*

*ASIMI — (I mbetur vetëm.) E habitshme! (Ulet pranë tavolinës, duke vënë kokën midis dy duarve.) Kurrë s'e prisja këtë prej tij! (Mendohet.) Eh, çfarë tragjedie! I vënë në shenjë nga të dy palët! Po a ka mundësi që njeriu të jetë në të njëjtën kohë edhe hero edhe spiun? Jo. Në asnjë mënyrë... Sidoqoftë, kjo çështje duhet zgjidhur sa më shpejt. Po sikur të shkoja që sonte në Berat? Ku ta dish... Ndoshata Bariu është kthyer! (Vendos.) Po, po, s'duhet humbur asnjë çast. (Vesh kapotën dhe bëhet gati të dalë. Hyn nëna.)*

*NËNA — Për ku kështu, Asim?*

*ASIMI — Diku kam punë, nënë. Mos më prit sonte. Në u kthefsha, e çel vetë derën. (Tregon çelësin.)*

*NËNA — Ti s'je mirë, bir! (E shqetësuar e shikon në sy, duke i hedhur të dy duart mbi supe.)*

*ASIMI — Nënë! (I lëmon flokët. E përqafon.)*

*NËNA — Kam një porosi. Xhaxha Zeneli erdhi e të kërkoi kur po bisedoje me Irenën e Mehmetin. Vinte nga Kola. Nga shtëpia. «Eh, moj Esma, — më tha, — ta shikosh si e kanë bërë!»*

*ASIMI — E liruan?!*

*NËNA — Po. Tri orë më parë. Kishte dashur të kthej këtu, po nga frika mos të të dëmtonte ty, ishte larguar.*

*ASIMI* — Mua? Nga kush?

*NËNA* — Nga armiku, Asim. Atë me siguri e gjurmojnë. Kështu i kishte thënë edhe Xhaxha Zenelit. Pastaj e kishte latur: «Thuaj Asimit do të dukem sa të erret. Po të ketë mundësi le të më presë!»

*ASIMI* — Ashtu? Po shkoj unë tek ai. (*Befas ndihet një trokitje në portë.*)

*NËNA* — Ndoshta ai! (*Del të shikojë. Hyn Kola. I parruar, me një fasho të gjakosur në ballë. Asimi shtang për një çast e pastaj bën një hap drejt tij.*)

*ASIMI* — Ti?

*KOLA* — Po. Unë...

*ASIMI* — Oh, si të paskan shëmtuar në këtë mënyrë? (Derdhet dhe e përqafon.)

*KOLA* — Mos u ligshto. Do të vijë një ditë që do t'i paguajnë të gjitha këto që po bëjnë!

*ASIMI* — Vërtetë gjaksorë!

*KOLA* — Dielli nuk u futka në thes, Asim. Po këtë herë i njoja edhe më mirë. Veç një gjë le të dinë: asnë mjet i tyre s'do të arrijë ta thyejë shpirtin e tanëve.

*ASIMI* — Sa më gëzon, Kolë, tek të dëgjoj që më flet kështu.

*KOLA* — Megjithatë, vetja më duket mizë përrpara atyre djemve që pashë! Çfarë torturash, Asim! Po edhe çfarë qëndrese ama! Ua prisnin mishrat e ua mbushnin me kripë. Herë-herë ua digjin me hekur të nxeh të, të futur në zjarr... Po ata kurrë s'i pashë të thyheshin për asnë çast, kurrë s'i dëgjoja të bënin një herë «oh!».

*ASIMI* — Pse, kë pate rast të shihje a të dëgjoje prej tyre, Kolë?

*KOLA* — Ditët e para, Tel Andonin, kurse më pas edhe dy të tjera, të ardhur nga Tirana, që s'do t'i harroj kurrë sa të jem gjallë. Mendohej se ishin të deleguar të Komitetit Qendror të Partisë. Quheshin Alqi Kondi e Hajdar Dushi. Thuhej se kishin vepruar edhe këtu në Kuçovë për organizimin e celulave të Partisë.

*ASIMI* — Po më habit! Pate rast t'i shikoje e t'i njihje për së afërmë?

*KOLA* — Po. Disa ditë i patëm birucat pranë e pranë.  
Dy luanë të vërtetë, Asim.

*ASIMI* — Vazhdo, vazhdo!

*KOLA* — Pas torturave i afroheshin murit ndarës e më jepnin kurajë: «Duro, shok» kurse prej gojës së tyre në ato çaste të vështira s'dëgjova fjalë tjetër veç përgjigjes së njohur: «S'di gjë» e «nuk e njoh».

*ASIMI* — (*I gjëzuar*) Ashtu ë?!

*KOLA* — Po. E, në ato çaste tërbimi, Gabrieli, duke iu drejtuar njerit prej tyre, dëgjova me këta veshë kur i tha: «Nuk po të torturoj, por po më torturon, Alqi Kondi. Kam nevojë të të dëgjoj t'ia bësh një herë «oh!» dhe po të lëshoj!» Po ai iu përgjigj: «Atë kënaqësi s'kam pér të ta dhënë kurër, marshall Gabriel! — dhe e pështyu në fytyrë.

*ASIMI* — Tamam ashtu siç flitet edhe në popull!

*KOLA* — Jam dëshmitar i kësaj të vërtete, Asim!  
Ndaj edhe të thashë: më duket vetja mizë tek i mendoj ata djem! (*Bën sikur i merren mendtë. Rënkon*) Oh! (*Eshtë gati të bjerë, Asimi shpejton dhe e mban*).

*ASIMI* — C'pate, Kolë?

*KOLA* — S'di pse m'u muarën mendtë! Ndoshata nga ajo birucë e zezë!..

*ASIMI* — (*Me shqetësim*) Po tani, si ndihesh?

*KOLA* — (*Si i lodhur*) Jo mirë! (*Mendohet*) Sidoqoftë, ka ardhur koha ta them edhe unë fjalën time të prerë. Nëse gjer më dje, siç e di, jam penguar nga qendra e grupit pér t'u hedhur hapët në luftë, tani urrejtja më shtyn të hakmerrem deri në fund pér ato që hoqa e pashë. Ti paskëshe pasur të drejtë që e çave i pari këtë rrugë. Sidoqoftë ja lutja pér pranim që dua t'i drejtoj Partisë. S'di cila do të jetë përgjigjja e saj. Po të mundesh, merre dhe jepja Metushit dhe thuaj se Kolë Dollanaj, tani e tutje, njeh vetëm një udhëheqie të klasës e të vendit mbi këtë tokë: Partinë Komuniste Shqiptare dhe si ushtarështë gati të presë çdo urdhër të saj.

*ASIMI* — (*I emocionuar*) Sa më gjëzon që ke arritur në këtë përfundim. (*Duke marrë lutjen*) Në mos Metushit, do të di unë se kuit do t'ia coj këtë lutje!

*KOLA* — Të falem nderit. S'do të ta harroj kurër këtë që po bën pér mua!

*ASIMI* — (*Me mirédashje.*) Mos e thuaj atë fjalë!

*KOLA* — Kështu, kështu si po të them unë. Dhe falmë. Po iki, Asim.

*ASIMI* — Ku? Jo, jo, Ulu, ulu, Kolë! Kaq kohë që s'jemi parë!

*KOLA* — (*Psherëtin.*) Në asnje mënyrë. Kolë Dollanajn e gjurmojnë, Asim! Ndaj nuk të erdha ditën. Po iki, shok! Po iki! (*Bën sikur i merren mendtë.*)

*ASIMI* — (*Duke e mbajtur*) Ti nuk je mirë!

*KOLA* — (*Në pritje «për të marrë veten».*) Mbetem në përgjigjen tënde. Ndoshata ajo do të më ishte shërimi i vërtetë. Lamtumirë!

*ASIMI* — Atëherë, po të përcjell.

*KOLA* — Jo. Të thashë: Të dëmtoj! (*Befas ndihen shpërthime e pastaj flakë që reflektohen edhe në dhomë. Pauzë e gjatë. Hedh sytë nga dritarja.*) Distileria! Me siguri shokët!

*ASIMI* — (*I përhumbur*) Shokët?! Ah, po... Shokët... (*I afrohet edhe ai dritares.*)

*KOLA* — Çfarë flakësh! S'do të kem nevojë për dritë gjer në shtëpi! (*Bën të dalë*) S'është mirë të më shohin në orët e vona rrugës. Po largohem, Asim! Veç mos më harro amanetin që të lashë! Ti e di se ç'do të thotë: tankth i pritjes! Sidomos në rastin tim...

*ASIMI* — Do të bëj çmos: :::

*KOLA* — Edhe njëherë të falemnderit dhe natën e mirë! (*I shtrin dorën.*)

*ASIMI* — Jo. Unë të thashë: do të të përcjell. Të pak-tën gjer te kthesa që merr për në pjacë... (*I fut krahun.*)

*ASIMI* — Eh, Asim Asim! Ti gjithë i patundur në ato që vendos. (*E shikon ngrohtë. Dalin. Bie perdja.*)

*Në njërin kënd të paraskenës duken Asimi e Kola për krahur. Kola ndalet.*

*KOLA* — Pra, gjer këtu! Tani gjithçka varet prej teje dhe prej tyre. Të thashë, thuaji Metushit... (*Po befas fjala i ngrin në gojë. Në këndin tjetër të paraskenës duket Çelik Zana, që vë dorën në brez. Është në pozicion e në vritë për të veçuar Kolën e për të shtënë mbi të. Asimi e sheh, dhe duke e zbrapsur e nxjerr Kolë Dollanajn jashtë këndit të*

paraskenës, kurse vetë, duke bërë përpara i del përballë Çelik Zanës.)

ASIMI — Hiqe dorën që andej! Kë deshe të qëlloje nga ne të dy? Apo me një të shtënë të dy bashkë?

ÇELIKU — Tani pér tani, s'e pata me ty!

ASIMI — Ahaaa! Tani pér tani e pate me të... Provoje po të mundësh. (Vë dorën në brez.)

ÇELIKU — (Me përbuzje.) S'ka nevojë. Këtu do të jemi. Veçse një gjë të dish: nga njeriu ynë i brendshëm në kuesturë... Nejse! Ne do të shihemi përsëri, Asim Zagora... (Largojet,)

ASIMI — (I shqetësuar.) Nga njeriu ynë i brendshëm në kuesturë? Po pse nuk e shfaqi të plotë mendimin? Ç'farë nga njeriu ynë i brendshëm? Apo ndoshta është vërtetuar dyshimi pér të cilin më folën Mehmeti, Irena, xha Thanasi? Si?! Të jetë arrestimi dhe tortura e Kolës një lojë e kuesturës? E pamundur! Po sikur... Çfarë?! Oh, ai do të ishte një tmerr pa fund pér mua! Jo, nuk më besohet të jetë ashtu. Megjithatë, ai duhej të më kishte folur... Bile të më kishte folur hapur! (Shpejton gjer në kënd të paraskenës.) Ja ku duket! (Thërret.) Çelik! Çelik! (I trondit.) Po pse nuk më përgjigjet, xhanëm? (Psherëtin.) Apo mos ndoshta me të vërtetë?! (Hyn Kola. Ai e ka dëgjuar bisedën.)

KOLA — Cfarë qe ajo, Asim?

ASIMI — (Duke mbledhur veten.) Një çështje e brendshme midis meje dhë atij.

KOLA — Vetëm kaq?

ASIMI — Të thashë: një çështje e brendshme midis meje dhe atij.

KOLA — Nejse! (Me nëntekst.) Unë s'dua të hyj në çështjet tuaja të brendshme. Sidoqoftë, mos më harro pér sa t'u luta! Natën e mirë!

ASIMI — (I trondit.) Natën e mirë! (Nisen pér të dalë në drejtime të kundërtat, Asimi del më parë.)

KOLA — (I tmerruar.) Loja u zbulua nga njeriu i tyre i brendshëm? Njeriu i tyre i brendshëm? Ndaj erdhi me dorë në brez? Ptu! (Del. Hapet perdja. Në skenë Metushi i ulur duke shkruar. Irena e tetova diçka po rregullojnë nëpër dhomë. Hyn Tafili.)

*METUSHI* — E? A e takove Mehmetin?

*TAFILI* — Po. Më në fund, po. Më quditit, me ç'më tregoi. Edhe një letër i qenkësh gjetur mbi trup kapitenit të vrarë!

*METUSHI* — Letër?

*IRENA* — Letër?!

*TAFILI* — Po. Një copë pusulle me fjalë të kursyera: «Të vrava në emër të Vasos së parritur, kapiten!»

*TETOJA* — Të Vasos?

*METUSHI* — Ashtuuu?! (*Mendohet.*)

*IRENA* — Po ç'firmë mbante poshtë ai shënim?

*TAFILI* — Nuk kishte firmë. Kurse shkrimi ishte me gërmë të mëdha dhe nga dora e një njeriu gjysmanalfabet.

*IRENA* — E quditshme! Ndoshta ndonjë nga tanët i lidhur ngushtë me lëvizjen.

*TAFILI* — Po kush të jetë ky i panjohur, që ka marrë këtë guxim. Kapiteni Anxhelo ishte nga ata që ruhej më shumë nga të gjithë...

*METUSHI* — (*I menduar.*) Vërtet e quditshme! E katërtat ditë dhe akoma s'po mundim t'i biem në të!

*TETOJA* — (*Psherëtin.*) S'dua të ta fsheh, Metush, lot s'kam derdhur për asnjë çast, po dhe mendja për asnjë çast s'më hiqet prej tij. I parrituri i nënës! (*Nxjerr nga gjiri një fotografi të Vasos.*) Ja, këtu e mbaj, more bir. E shikoj sa çmallem, pastaj, e heshtur, e puth. Po ku çmallen dot nënët me fëmijët e tyre të vetëm?

*METUSHI* — Ke të drejtë, teto Katinë. Po nuk do të jetë e largët dita kur Vasoja sërisht do të jetë midis nesh.

*TETOJA* — Të rrosh, more bir. (*Në dhomën matanë dëgjohen të kollitura.*)

*METUSHI* — Mërkuri?

*TETOJA* — Po.

*METUSHI* — Nuk jam aspak i qetë për shëndetin e këtij shoku, teto Katinë. Po a e lajmëruan të vijë?

*TETOJA* — Po, more Metush. I shkreti djalë! Megjithëse ruhej e s'donte që unë ta diktoja, prapëseprapë, një ditë. tek pështyu diç më zunë sytë...

*METUSHI* — Gjak?

**TETOJA** — Po. Kaq kohë që jeton e punon nëpër bодруме...

**METUSHI** — Jo, kjo gjendje nuk mund të lihet kësh-tu! Ne jemi përgjegjës për jetën e këtij shoku. Unë me ko-hë kam dashur që ai të shtrohej. Po këtë radhë, me ven-dim të organizatës, do ta detyrojmë.

**TETOJA** — Ah, sikur ta bënët këtë, more bir!

(*Hyn Karadaku e pas tij edhe Mërkuri.*)

**KARADAKU** — Drejtorin e përgjithshëm të naftës e pushuan.

**MËRKURI** — Cilin?

**METUSHI** — Barbierin, Mërkur! Komisioni i kontro-llit, i dërguar nga Roma, ka ditë që po heton këtu. Grupet tonë të sabotimit e thanë fjalën e tyre të fuqishme.

**MËRKURI** — Siii? Gjer këtu arriti të ndihet forca e këtij grushti?

**KARADAKU** — (*Mërkurit, me dashuri dhe entuzia-zëm.*) Po, Mërkur. Jashtë, nëpër kantier, zien çështja e deficítit të naftës. Vetë funksionarët e AIPA-s thonë: «Shif-rat në raportet ditore e mujore në rregull, gjithashtu ato në telegramet që i nisen Romës, po një e treta e naftës në-për depot mungon».

**MËRKURI** — Ju lumtë grupeve të sabotimit. Me të vërtetë punë e madhe.

**KARADAKU** — Të alarmuar prej ditësh, kontrollorët e sektorëve po bëjnë çmos ta nuhasin e ta zbulojnë këtë mister...

**TETOJA** — Po a kanë rënë në ndonjë gjurmë, more bir?

**KARADAKU** — Aspak, teto Katinë. Dhe as kanë për-të rënë. Punëtorët, me syrin shpuzë, edhe në këto çaste, kur mbikëqyrësit italianë iu rrinë mbi kokë, s'e kanë pre-rë sulmin e tyre.

**METUSHI** — Pra, sabotimi vazhdon.

**KARADAKU** — Pa asnjë ndërprerje. Dhe pikërisht kjo i habit e po i tmerron në të njëjtën kohë!

**METUSHI** — Ja, shokë, parashikimi i shokut Shpati. Tanimë përpjekja jonë s'është më sulmi i një grushti revo-

lucionarësh, po lufta e gjithë proletarëve të këtij kantieri të madh. (*Tetoja e emocionuar kthen kokën e fshin një lot.*)

**MERKURI** — Ç'pate, teto Katinë?

**TETOJA** — Nga gëzimi, more Mërkur! Kur lufta ju shkon mbarë, ne nënët gëzojmë fort...

**KARADAKU** — Një ditë, këta luftëtarë do të na përgjigjen edhe për të dalë maleve, teto Katinë.

**METUSHI** — Tamam ashtu! (*Irenës*) Irenë, mos harro të shkruash sot komunikatën rreth kësaj ngjarjeje të mëdhe! Dhe këtu s'është fjala për rrëzimin e Barbierit, se Barbierët venë e vinë, po për rezultatet që ka arritur ky aksion i madh e masiv i proletarëve të këtij qyteti. Ja, kjo duhet të dalë.

**IRENA** — Mos ki merak, Metush.

**METUSHI** — (*Mërkurit.*) Me vendim të organizatës së partisë, Karadaku është ngarkuar të interesohet për diçka në lidhje me ty. Do të ta thotë më vonë. Do ta dëgjosh e do ta kryesh porosinë me përpikmëri. Më kupton, Mërkur? Është vendim Partie.

**MËRKURI** — Si nuk do ta kryej gjersa është urdhëri i Partisë? Po pse s'më thua për çfarë është kjo porosi?

**METUSHI** — Do të ta thotë Karadaku.

**MËRKURI** — Mirë. Mund të largohem?

**METUSHI** — Po. (*Me mirëdashje.*) E di që e ke hallinte puna që ke lënë në mes.

**MËRKURI** — (*Irenës.*) Mos e vono komunikatën!

**IRENA** — Jo. (*Mërkuri del. Hyn Mehmeti.*)

**METUSHI** — (*Mehmetit*) Po Çeliku përsë u vonua kaq fort? (*Shikon orën.*)

**MEHMETI** — Pse? Akoma s'paska ardhur?

**TETOJA** — Gjithnjë në halle e në pritje, more bij!

**METUSHI** — Po, teto Katinë! Sa të mbarojë kjo luftë. Pastaj ndryshe do të jetë bota jonë...

**TETOJA** — Eh, more Metush, zahmet të gjejë rehat kjo botë!

**KARADAKU** — Ashtu është. Po bota që mendojmë ne do të jetë ndryshe, teto Katinë.

**TETOJA** — Të rroni, more bij? Ju vërtet luftoni për të drejtën dhe të mirën e njerëzisë! (*E menduar.*) Po Asi-

mi, xhanëm? U bënë mjaft ditë që riuk e kam parë! Sa më dhimset! Dikur tek unë e kishte folenë! Eh, i shkreti djalë, si e pësoi! (*Hyn Çeliku.*)

**ÇELIKU** — Për kë e kishe fjalën, teto Katinë?

**TETOJA** — Për Asimin.

**ÇELIKU** — Ai vdiq! (*Mehmeti hedh vështrimin me shqetësim nga Çeliku.*)

**TETOJA** — Çfaaarë? (*Irena shtang.*)

**ÇELIKU** — (*Tetos.*) Mos u shqetëso! Vdekja me nder është lule, po ai e mylli me turp, teto Katinë! Për mendimin tim tani, Asim Zagora s'është gjë tjetër veçse një Kolë Dollanaj i dytë. Dhe për Kolë Dollanajt ka vetëm një shpërblim: plumbin në lule të ballit.

**TETOJA** — Jo, more Çelik, mos fol me atë gjuhë për të... (*Del e pikëlluar.*)

**METUSHI** — (*Serioz*) Si është puna?

**ÇELIKU** — E shkreta grua! Megjithëse tani bën pjesë edhe në një nga grupet edukative e fjalët «zot» e «shën Mëri» i zë rrallë në gojë, prapëseprapë çështjet tona ende s'i kupton dot në thellësi. Ja si ngjau, shokë. Siç e dini, dje në mesditë, njeriu ynë i brendshëm në kuesturë na informoi se Kolë Dollanajn do ta nxirrin mbas disa orësh e se arrestimi e tortura e tij s'ishin gjë tjetër veçse një lojë e rrezikshme e armikut për ta futur atë midis nesh. Mbas kësaj informate dhe pas vendimit të celulës për ta pritur me plumb Kolë Dollanajn, unë u vura menjëherë në gjurmim të tij. Dhe ç'është e vërteta me të dalë ia gjeta anën për ta qëruar njëherë e mirë. Po për fat, Asim Zagora që iu ndodh pranë, e zmbrapsi e iu bë mburojë. Edhe për pak e ua shkrepë të dyve. Megjithatë, paralajmërimin ia bëra hapët. Ne do të shihemi përsëri, Asim Zagora!

**MEHMETI** — Mos, more trim, se s'është mirë ashtu! Ne po luftojmë ta bindim, mbasi ai beson singerisht se Kolë Dollanaj është i pafajshëm, kurse ti, jo vetëm që shkon ta qëllosh në sy të tij, po kërkon edhe t'i qërosh të dy me një të shtënë...

**KARADAKU** — Ky nuk është takt, Çelik! Kola duhej qëruar patjetër, po jo në prani të Asimit.

**TAFILI** — Edhe unë ashtu mendoj.

**MEHMETI** — (*Celikut.*) E po të ishte se ka shkuar aq larg, siç e akuzove ti tani, ç'kanë pritur armiqtë që s'kanë vënë dorë mbi ne, e sidomos mbi ty, Çelik? Ndaj mendoj se shpejtohesh, shok!

**METUSHI** — Po ti, Irenë, përse nuk flet?

**IRENA** — Unë i bindem gjyqit dhe vendimit të shokëve, Metush.

**METUSHI** — Shokë! Ju folët urtë. Ne, komunistët gjithnjë duhet të jemi të gjerë. Sigurisht Asim Zagora me këtë qëndrim e largim nga njësiti s'është pa gabim e faj. Po ndër vlerësimet tuaja, ai i Mehmetit dhe i Tafilit m'u dukën më të plotët. Edhe unë mendoj e besoj se Asim Zagora mund dhe duhet të mbetet yni. Por kjo duhet arritur me gjakftohtësi, duke i dhënë dorën me durim.

**ÇELIKU** — (*I menduar.*) Ndoshta veprova pa takt, por mbrojtja që i bëri Kolë Dollanajt i dha edhe më shumë hov mërisë sime të acaruar. Sidoqoftë uroj që ai të jetë i pastër, pa le të jem unë në gabim... Kurse përsa i takon spinjt Kolë Dollanaj, ju premtoj se brenda dy-tri ditëve të ardhme do t'ia dëgjoni fundin.

**METUSHI** — Ai duhet qëruar menjëherë. Edhe Komiteti Qarkor, në një lëfër që posa na mbërriti, na porosit që punën e tij të mos e zgjasim asnje çast. Unë besoj, shokë, se kjo letër ka për ta sjellë në vete edhe Asim Zagoren që i ka varur të gjitha shpresat te Komiteti Qarkor.

**ÇELIKU** — Ndoshta...

**METUSHI** — Kurse në shënimin poshtë kësaj letre, Komiteti Qarkor na informon se sot gjykohet para popullit dhe partizanëve, për gjithë veprimtarinë e tij tradh-tare, trockisti Anastas Lula.

**ÇELIKU** — Bile shumë është pritur.

**METUSHI** — Gjithashtu vihemë në dijeni se, mbasi u këshilluan disa herë e s'hoqën dorë nga rruga e tyre e tradhtisë si grupazhë e fraksionistë të lidhur me Anastas Lulën, Guri Kolonaj, Kostë Kalaja dhe Mazar Kuta u përjashtuan nga Partia dhe u urdhëruan që të shpërndehen në tre nga njësitet partizane të qarkut. Si e kanë pritur këtë vendim dhe a do ta zbatojnë, ende nuk dihet. Ko-ha do ta zbulojë edhe më qartë fytyrën e tyre.

**MEHMETI** — S'ma merr mendja të bëjnë kthesë. Ata janë kopje e Anastas Lulës dhe brumë i të njëjtët miell, Metush!

**METUSHI** — Sidoqoftë, Partia u la edhe një shteg të fundit përpëra humnerës. Kaq rrëth tyre, kurse në qarkun e Vlorës, lufta për asgjësimin e fraksionit u organizua me parullën «Partia mbi të gjitha». Duke shkuar vetë në vend shoku Shpati, së bashku me shokët Besnik e Vjosë, e ngritën peshë organizatën e Partisë në qark. I dërmuar, frakzioni u asgjësua përfundimisht. Tani tradhtari Sadik Premte s'po gjen vrimë ku të futet. Për hollësirat do t'ju vemë në dijeni më vonë.

**KARADAKU** — Fort bukur.

**METUSHI** — Tani le të kthehem i tek një çështje jona e brendshme me rëndësi të veçantë. Dje anulluam aksionin kundër depos së karburanteve dhe iu vërsulëm distillerisë në një kohë kur armiku s'e priste. Anullimi u bë për shkak se kuestura kishte arritur ta hetonte goditjen që do të bënim në karburant. Në këtë zbulim, siç na informoi njeriu ynë i brendshëm, kuesturën e kishte ndihmuar trockisti Laze Gjinaj, i cili kishte përmendur atje se këtë informatë e kishte nga një informator me emrin Daka.

**KARADAKU** — (*Mënjanë. I tronditut*) Dako?! Dako?!  
Mos vallë, Mentor Dakaj??!

**METUSHI** — Sipas të dhënave të tij, vendin ku do të kryenin aksionin, me t'u errur, e kishin rrëthuar me forca të shumta, duke lënë vetëm një shteg hyrjeje. Dhe këtë, jo pa qëllim. Pra, po të kishim hyrë, kuptohet se ç'mund të na kishte ndodhur. Pyes: veg nesh, askush s'dinte gjë rrëth këtij veprimi, atëherë, kush prej nesh ka dekonspiruar?

**CELIKU** — Prej nesh?

**MEHMETI** — Prej nesh the? (*Heshtje; të gjithë shikojnë njëri-tjetrin në sy. Karadaku ul kokën.*)

**METUSHI** — Edhe njëherë ju pyes, shokë, kush nga ne ka dekonspiruar?

**KARADAKU** — (*I zbetë*) Unë... (*Të gjithë vështrojnë me habi drejt tij. Gjendje e nderë.*) Ju flas me zemër të hapët. Vdekjen e dija, po që Mentor Dakaj të ishte i tillë,

kurrë s'e kisha shkuar ndër mend. Unë e di atë në grupet edukative të Partisë! Më pyeti si pa të keq: «A do të kemi së afërmi ndonjë lajm të gëzuar? Ndonjë grusht të ri që t'i tmerrojë armiqtë?» dhe unë, duke e quajtur tonin, s'di si u gjeta bosh e i thashë: «Me sa duket, sonte i erdhia rada depos së karburantëve!»

**METUSHI** — Shumë keq! Këtë akt dekonspirimi, me gjithë pohimin e singertë të shokut Karadak, ne do ta gjykojmë në organizatë.

**KARADAKU** — Unë tani po e kuptoj ç'lak i paskam ngritur njësitit! . . .

**ÇELIKU** — Shokë, kjo vërteton edhe njëherë se kush është Kolë Dollanaj, shoku dhe miku i Laze Gjinajt. Propozoj, sikurse i pari, edhe zjarristi e spiuni Laze Gjinajt me tradhtarin Mentor Dakaj, të marrin menjëherë të njëjtin ndëshkim.

**KARADAKU** — Do t'u lutesha të dy së bashku të m'i linit mua në kujdes. Do të përpinqem t'i shpërblej tamam sipas gradës që u takon...

**TAFILI** — (*Karadakut*) Jo, Karadak. Ti Mentorin e unë Lazen. Kështu dhe puna do të kryhej më shpejt.

**METUSHI** — Dakord me propozimin e Tafilit. Si thoni, shokë?

**ZERA** — Dakord!

**METUSHI** — Mirë. U vendos. (*Shikon orën*) Qenke mi vonë! Ti Tafil dhe ti Çelik menjëherë duhet të kujdeseni për mbledhjen e orës nëntë, ku do të marrin pjesë të gjithë përgjegjësat e grupeve të sabotazhit të naftës. Vendi i mbledhjes në sektorin nr. 4, te Gjergji. Mendoj që të dy të niseni pa humbur asnje çast. Ti Tafil, në njërin krah, kurse Çeliку në tjetrin. Zona është mjaft e hapur, siç e dini.

**TAFILI e ÇELIKU** — (*Ngrihen*) Vdekje Fashizmit! (*Nderojnë me grusht e dalin*.)

**ZERA** — Liri Popullit!

**METUSHI** — Kurse ti, Karadak, siç biseduam, do të interesohesh për Mërkurin, Kur të mbarosh, eja atje ku do të jemi të gjithë!

**KARADAKU** — Po.

*METUSHI* — Pra, mirupafshim. (*Nderojnë me grusht bashkë me Mehmetin dhe dalin. Edhe Irena e Karadaku nderojnë me grusht.*)

*IRENA* — (*Kontrollon me sy nga dritarja, gjersa Metushi e Mehmeti s'dukan më.*) Kaluan!

(*Hyn Mërkuri*)

*MËRKURI* — Paskan shkuar? Erdha për komunikatën, Irenë.

*KARADAKU* — Tani na mbeti radha ne të dyve, Mërkur. Me vendim të Partisë, siç na tha Metushi, ti do të largohesh që këtej... Do të të zëvendësojë me shok tjetër.

*MËRKURI* — (*Me shqetësim*). Të largo hem? Po ç'kam bërë që të largo hem?

*KARADAKU* — Asgjë të keqe. Ti je hero me punën që ke bërë. Po shokët janë të shqetësuar për shëndetin tënd. Kohët e fundit ke rënë mjaft.

*MËRKURI* — Për këtë kërkoni të më largoni?

*KARADAKU* — Mos e quaj gjë të pakët. Metushi për këtë çështje ka kohë që s'është i qetë... Me gjithë punët e shumta që ka, ai vetë u kujdes edhe për shërimin tënd. Do të të kurojë një mjek yni që punon në Berat.

*MËRKURI* — Sii? S'mjafton që s'po marr pjesë në sheshet e luftës, por dashki që edhe që këtej t'i bëj punës bisht? Oh, jo! Kurrën e kurrës Karadak!

*KARADAKU* — Mos harro se ky është vendim Partie! Dhe kjo, padyshim, është në dobi të punës e të luftës në të ardhmen. Po edhe në të mirën tënde. Pra, duhet të dëgjosh!

*MËRKURI* — (*I nxehur*.) Ju falem nderit, po këtë radhë nuk do ta zbatoj këtë vendim (*Kollitet*) Vdekjen në shtrat e urrej, aq më tepër kur mendoj se shokët orë e çast janë përballë saj! (*Irenës*) Eja! Mos harro porosinë e Metushit: duhet të pregatisim komunikatën me lajmet e ditës! (*Del.*)

KARADAKU — Mërkur! Mërkur! Mërkur! (Pau-zë. Dëgjohet kollitja e tij e vazhdueshme.) Njeri i çuditshëm!

IRENA — (Me keqardhje.) Ka sedër të fortë, Karadak!

(Erret skena. Në paraskenë shihet Asimi duke kalluar e gati për të dalë nga këndi tjetër. Nga pas, një qytetar i shkuar në moshë rend me zor e i thërret:)

QYTETARI — (Duke iu marrë fryma.) Asim! Asim!

ASIMI — (Ndal e kthehet andej nga vjen zëri. Duke iu afruar njeriut që po shpejton.) Po përse po rendni kështu?

QYTETARI — Bir! S'dija kujt t'i drejtohesha. Shyqyr që m'u gjete këtu pranë! Metushi e të tjerët janë në rrezik!

ASIMI — (Me tronditje.) Rrezik?

QYTETARI — Po. I pashë tek hynë në barakën e rrotës nr. 24. Ndoshta ndonjë mbledhje. Po mbas hyrjes së tyre, pikërisht në atë drejtim, vura re me automatik në duar marshallin Gabriel të shoqëruar nga 4 policë. Të kërrusur, po shpejtonin anës hendeqeve. Diçka po ndodh, thashë me vete. Kur, për çudi, në krahun tjetër më zunë sytë edhe Kolë Dollanajn, duke rendur afër tyre.

ASIMI — Kolën? Kolën me marshall Gabrielin?

QYTETARI — Po, Asim. E pashë me këta sy! Atëherë dyshimi m'u përforcua dhe u rashë pas në heshtje. Tani, ai, s'është më një dyshim, por një rrezik që po u kërcënë jetën djemve.

ASIMI — Po qëkur i keni parë ashtu?

QYTETARI — As pesë dekika gjithë-gjithë, more bir! As pesë dekika! Po e keqja bëhet në çast.

ASIMI — Ju falem nderit xha Andon! Falmëni! Ju lashë! (I tronditur shpejton e del. Mbas tij edhe qytetari. Hyn teto Katina me një bohçe në duar.)

TETOJA — Edhe nëna jote, Vaso, tani netve ka punë! (Hyn mësuesi pensionist Sokrat Isau).

MËSUESI — Këtu qënke, Katinë? Po pse në këtë orë?

**TETOJA** — Lufta s'ka orar, zoti Sokrat! (*Nxjerr e i jep një trakt.*) Këtu shkruan: «Lexoje! Shpërndaje! Mos ia dorëzo armikut!» Pra, kujdes!

**MËSUESI** — (I gëzuar.) Eh, motër, Katinë! (*I hedh dorën në sup.*) Të lumtë! Veç falmë që s'të erdha dot pér Vason e vogël! Isha në shtrat kur të ngjau fatkeqësia. Por, më beso, as im bir nuk mu dhims më fort. E kam pasur nxënës, Katinë...

**TETOJA** — Po ç'flitet pér Sotirin, xhanëm?

**MËSUESI** — E larguan që këtej. Kuestura më lajmëroi: «Mos e kërko më ndër ne. Yt bir u dërgua në burgun e Tiranës...»

**TETOJA** — (Psherëtin.) Të të kthehet shëndoshë, zoti Sokrat. (Pauzë). Po kush mendoni se e spiunoi?

**MËSUESI** — Shokët e Kolë Dollanajt, Katinë! Pra, shokët e Asim Zagorës, që u bashkua me djemtë tanë e postaj i tradhtoi.

**TETOJA** — Jo. Asimin mos e vini në një shkallë me ata, zoti Sokrat.

**MËSUESI** — Gjersa braktisi shokët, të dy palët të një shkalle janë. Po s'di pse s'po ua çojnë shpirtin në djall?

**TETOJA** — E zeza? Jo! Asimit mos ia taknsi një gjë të tillë!

**MËSUESI** — Si të them unë, Katinë! Gjarpérinjtë dinë vetëm të kafshojnë. T'u shtypësh kokën, është sevap! Po të lë, motër! (*Del.*)

**TETOJA** — (E tronditür.) Si? Edhe Asimit?! (*Del.*  
*Hyn Gabrieli me dy policë.*)

**GABRIELI** — (Policëve.) Barkas do t'i afrohemë barakës e pritni sa të vijë umë! (*Iu bën shënje pér t'u nisur. Policët dalin.*) Po pse më lajmëroi ta pres medoemos? A s'e di ai porosinë e të ndjerit kapiten Anxhelo? Takimi me mua ose të tjerrë nga ne mund ta zbulojë dhe plani dështron përfundimisht... Si! Nuk e di ky këtë? (*Shikon orën.*) Po pse po vonohet! (*I shqetësuar kalon nga njëri kënd i paraskenës në tjetrin. Hyn Kola.*)

**KOLA** — (I merret fryma.) Përshëndetje, mik Gabriel!

*GABRIELI* — (Serioz.) Buona sera! Po ç'është gjithë kjo këmbëngulje pér takim? A s'e dini ju se?...

*KOLA* — Gjithçka mori fund!

*GABRIELI* — Çfarë? (Befas pret fjalën. Hyjnë rrresh-ter Ugolini me dy policë, me Çelikun të arrestuar e duar-lidhur. Gabrieli çelet në fytyrë.) Ahaa! Chi si vede\*! (Ugolinit) E kapët, ë?

*UGOLINI* — Sinjor si! Sipas urdhërit tua!

*GABRIELI* — Fort mirë! Çojeni, se pas pak do t'ua sjellim edhe të tjerët.

*KOLA* — (Çelikut.) Si e ndjen veten tani, i ndruar? Me këto duar (*ia tregon*) do të t'i thyej brinjët!

*ÇELIKU* — Spiun!

*GABRIELI* — S'e vlen të merresh me të! (Çelikut.) Mirupafshim pak më vonë, Çelik Zana! (Ugolinit) Nisuni!

*KOLA* — (Ugolinit.) Më duket i ka duart të lira. (Një nga policët ia shtrëngon hekurat. Kola me ironi Çelikut.) Besoj kështu është edhe më mirë! Mirupafshim. Kam mall t'ju takoj sa më parë!

*ÇELIKU* — (Krenar, me përbuzje) Më vjen ndot tek të shikoj. Krimb i ndyrë.

*UGOLINI* — Avanti! Avanti! (Nisen e dalin, në kthesë të paraskenës i kalojnë përbri Asimit që porsa ka mbërritur. Ai shtang e tronditet kur e shikon në atë gjendje Çelikun, por Çeliku i qetë kalon dhe e shikon me përbuzje.

*ÇELIKU* — Ptu!

*ASIMI* — (I vetëm, i trondit, bri paraskenës.) Oh, çfarë tmerri! Po kush ta ketë?... (Mendohet.) Kola?! (Një zë nga paraskena i tërheq vëmendjen. Ai ndalet e mundohet të dëgjojë.)

*GABRIELI* — Tani fol, se s'po më pritet. Çfarë ka ndodhur që më kërkove me çdo kusht takim? Ne, me të ashtuquajturën arrestë e torturë tënden, krijuam një

\* Kush na qenka!

legjendë të tërë në qytet, kurse ti, me një takim të kotë, kérkon të na i shëmbësh të gjitha!

KOLA — Ajo kështjellë kartoni u bë shkrumb, Gabriel.

GABRIELI — Çfarë?

KOLA — Gjithçka mori fund. Sot zbulova përfundimisht se Asim Zagora është prishur me ta për shkakun tim. Kurse për legjenden që u munduat të krijonit, me sa duket një njeri i tyre i brendshëm, që punon në kuesturë, i ka informuar se ajo s'ka qenë gjë tjetër veçse një lojë e bllof nga ana juaj.

GABRIELI — Si?! Si?!

KOLA — Pra, shpresat për të hyrë me anë të Asim Zagorës në qëndër të organizatës së tyre, ka marrë fund përfundimisht.

GABRIELI — Mos kérkon të më çmendësh, Kolë Dollanaj? Po kush është ky njeri i brendshëm i tyre që punon te ne?

KOLA — Atë gjejeni vetë!

GABRIELI — Fol! Nga e more vesh ti një gjë të tillë?

KOLA — E dëgjova me këta veshë, kur Çelik Zana, i ngarkuar nga shokët e tij, erdhi të më qëllonte.

GABRIELI — Ashtu?

KOLA — Mos u çudit! Flasin e qëllojnë sheshit. Guximi i tyre është i marrë! U mbajt, se Asimi i nxori gjoksin dhe i doli përpara. Atje e pashë hapët pse kishte ardhur. Pastaj dëgjova edhe bisedën midis tyre. Pra, e qartë?...

GABRIELI — E çuditshme!

KOLA — Aspak. Ata kanë kohë që kanë vendosur t'i lajnë llogaritë me mua. Veçse gjëzohem që Çelikun, më në fund, e arrestuat.

GABRIELI — Ta hajë dreqi ta hajë (*I dërmuar moralisht. Psherëtin.*) C'ngjarje e lajme të hidhura gjatë këtyre dy ditëve! (*Pauzë.*) Sot në mëngjes edhe Anastasin...

KOLA — E pushkatuan?!

**GABRIELI** — Po. Pas një gjyqi të shkurtër, para partizanëve dhe popullit. Kurse Guri Kolanaj me dy të tjerë, të përjashtuar nga Partia, duke hedhur këtë trakt (*Nxjerr traktin*), e shpallin veten si degë të Partisë Komuniste të vërtetë, të kryesuar nga Sadik Premtja.

**KOLA** — Oh! (*I tronditur.*) Ç'më the, Gabriel! Dy disfata në një ditë!

**GABRIELI** — Kjo është vetëm një thërrmijë e së keqes, Kolë Dollanaj, kurse ajo që na preu krahët, është Vlora!

**KOLA** — Vlora? Po Sadiku në Vlorë...

**GABRIELI** — Ashtu u duk në fillim. Po me kthimin nga Labinoti të dy sekretarëve të Qarkorit, ndërtesa e ngritur prej tij dhe shokëve të tij u trondit keq në themel. Pastaj, siç informohemi me shkuarjen atje të një përfaqësuesi nga qendra e Partisë së tyre, ajo u shemb përfundimisht. I gjetur ngushtë, Sadiku, në krye të një grushti njerëzish të armatosur, u detyrua të strukej në Gjorm e Lepenicë.

**KOLA** — (*Me shqetësim.*) Pastaj?

**GABRIELI** — Por ata dhe atje nuk e lanë të merrte frymë. Mbasit e rrethuan zonën me njësite të lehtë, depërtuan në thellësi të Gjormit e Lepenicës dhe e shtinë në një pritë të fortë.

**KOLA** — E vranë?

**GABRIELI** — Vranë dikë tjetër nga shokët e tij. Ai mundi t'u dilte. Por tani, i dënuar me vdekje prej tyre, s'është gjë tjetër veçse një hije, a një i gjallë ndër të vdekurit, që pret të mbrohet nga bajonetat tona brenëda në Vlorë.

**KOLA** — Ç'më the, Gabriel! Ç'më the! E tmerrshme...

**GABRIELI** — Ja, ky që epilogu i tij! (*Psherëtin.*) Tani kam vetëm një dëshirë: të kap gjallë Metush Metën me shokët e tij të tjerë.

**KOLA** — Do dëshiroja, që bashkë me Çelik Zanën, t'i torturoja të dy me këto duar! (*Tregon duart e tij.*) Pikërisht kjo që edhe arsyaja që vendosa të vija sot me ty. Qëndrimi larg, këtej e tutje, do të thotë t'u jepet mundësi atyre të qërojnë hesapet sa më lehtë me mua.

**GABRIELI** — Dreqi e mori! Ndryshe shpresuam, kurse tani na u shtua edhe një Sadik tjetër me ty. (*I dëshpëruar*) Je i armatosur?

**KOLA** — Po. (*I tregon revolverin*)

**GABRIELI** — (*Duke shikuar orën.*) Në rregull. Dotë jenë mbledhur. Shpejt se u vonuam. (*Gabrieli del i pari, Kola bën të dalë, po Asimi del në kënd të paraskenës e i thërret:*)

**ASIMI** — Kolë! Prit! (*Kola shtang*) I kam dy fjalë me ty!

**KOLA** — (*I tronditur.*) Çfarë fjale?

**ASIMI** — Domethënë, Kolë, unë për ty... (*I qasët kërcënues*).

**KOLA** — Çfarë ti për mua?

**ASIMI** — Asgjë... I dëgjova të gjitha. E tani tmerrohem e pyes veten: për kë qënkam prishur unë me shokët? (*Kola mundohet të zmrapset.*) Prit! Prit! Nderi i fyter do të vihet në vend! Zgjimi i të mashtruarve është i tmerrshëm, Kolë Dollanaj!

**KOLA** — (*Duke marrë qëndrim.*) S'do të bëje keq të largoheshe sa s'është vonë!

**ASIMI** — (*Gjithnjë duke iu afruar.*) Mos bëj asnjë hap më tej! Ka ardhur çasti të më përgjigjesh për të gjitha!

**KOLA** — (*Zmrapset dhe nja dy hapa dhe, me shpejtësi, nxjerr revolverin dhe qëllon në befasi*) Ja, kjo është përgjigja, Asim Zagora! (*E plagos rëndë.*)

**ASIMI** — Oh! (*Por sado i plagosur, nxjerr revolverin e, flakë për flakë, shtie mbi të. Kola shpejton të dalë, por plumbi i dytë e rrok e ai bie jashtë skene.*)

(Në thellësi dëgjohet një zë)

**GABRIELI** — Ma koza çe, Kolë\*) Koza çe? (Vrapon në drejtim të skenës. Ndihen hapat e Gabrielit) Rispondi! Ki ha sparato?\*\*)

\*) Po c'po ndodh, Kolë?

\*\*) Kush ka shtënë?

*ASIMI* — (I qetë.) Tani do ta marrësh vesh «koza çë», gjarpër! (Del.)

*GABRIELI* — (Gjithnjë duke u afruar me vrap. Përsëri ndihet zëri i tij nga jashtë.) Ma perke non rispondi, Kolë?

*ASIMI* — (Që jashtë.) Ja përse... Të erdhi radha, ujk Gabriel! Ndal!

*GABRIELI* — (Thërret.) Dio mio! No! No! (Ndërkohë dëgjohen tri të shtëna revolveri e pastaj zhurma e një trupi që përmbyset. Në thellësi një zë.)

*ZËRI* — Shpejtoni! Shpejtoni! Policia! (Mbas pak, i dërmuar shpirtërisht hyn në paraskenë Asimi.)

*ASIMI* — Të qërova gjarpër me dy kokë! Edhe ty, ujk Gabriel! Eh, c'të papritura të çuditshme më zbuloi kjo natë! E dija të pastër e të pafaj, ndaj dhe e mbrojta aq fort. Por, ah, për kë qenkat prishur me shokët unë! Falmë, Çelik! Ti paskëshe pasur të drejtë! Dhe ti, Metush, e ju të gjithë shokët e mi të dashur e të shtrenjtë... .

(*Nga këndi tjetër i paraskenës hyn Thanasi.*)

*THANASI* — I pashë e i dëgjova të gjitha. Tani, besoj, gjithçka u sqarua.

*ASIMI* — E çuditshme! Kurrë s'e përfytyroja këtë fund!

*THANASI* — Ky është fundi i të gjithë atyre që tradh-tojnë. Revisionistët, qofshin nxënës të Kauckit, Breshtajnit apo Trockit, si deviatorë e tradhtarë të çështjes së proletariatit, pavarësisht nga lloji i maskave që përdorin, kanë të njëjtat qëllime dhe i pret i njëjtë fat. Ky është edhe fundi i Andrea Zisëve dhe Sadik Premteve, Asim! Lamtumirë! (Del.)

*ASIMI* — (I shtangur, me gjysmë zëri) Lamtumirë?! (E ndjek nga pas. Del. Hapet perdja. Skena në shtëpinë e teto Katinës. Në nim Irena e ulur, duke shkruar tekstin e një komunikate. Me revolvera në duar hyjnë Gjergji, Tafili, Metushi, Karadaku dhe punëtori roje. Të gjithë vendosin revolverat në brez. Irena ngrihet.)

*PUNËTORI* — Ja, siç ju tregovat rrugës, ashtu i vrou! Veç më vjen keq që atë njeri nuk e njoha.

**TAFILI** – Çfarë çudie!

**GJERGJI** – Vërtet e habitshme!

**MEHMETI** – Po kush nga tanët të ketë qenë ai?

**PUNËTORI** – S’ë di, more Mehmet, po guxim të atillë kurrë nuk kam parë me sy.

**METUSHI** – Po pastaj?

**PUNËTORI** – Pastaj, si roje që isha, vrapova ku ranë pushkët dhe gjeta këtë automatik pranë të huajit, kurse Kolë Dollanajt i gjeta revolverin dhe këtë portofol! (*Nxjerr portofolin.*)

**GJERGJI** – I vrau dhe s’ua mori?

**PUNËTORI** – Jo? As i preku me dorë! Veçse Kolës i hodhi një vështrim e i tha: «Më qafë paç veten, djall!» Kurse trupin e të huajit, duke e ngritur si leckë e përplasi mbi ‘të: «Thonë keni qenë miq! – i tha. – Kështu do dëshiroja të mbeteshit bashkë përngaherë!»

**MEHMETI** – Një trimi të tillë me gjithë zemër do t’ia kisha lëshuar komandën e njësitit.

**KARADAKU** – Pa shih ç’ka brenda ai portofol? (*Punëtori e hap.*)

**PUNËTORI** – (*Duke i nxjerrë sendet që ka brenda*) Para! (*I çuditur*) Ja dhe një listë me emra, more bij! (*Afrohen për të parë listën*)

**TAFILI** – I paska ndarë e nënvizuar: në komunistë dhe të *dyshimtë*.

**METUSHI** – Po tjetër a ka?

**TAFILI** – (*Pas një pauze*) Po! Paska edhe një letër drejtuar Kolës që mbaka datën e sotme dhe të firmosur... (*Shikon firmën me kujdes.*) nga Gabrieli!

**KARADAKU** – Lexoje, lexoje! Çfarë i shkruan?

**TAFILI** – (*Duke lexuar letrën:*) I dashur Kolë! S’është çudi që, pas një informate që kam, sonte Metush Metën ta hedh në dorë. Mbledhja e tyre do të bëhet në orën 9 të mbrëmjes, në sektorin nr. 4. Gjithashtu ki parasysh planin me Asimin (*pauzë*) dhe...

**IRENA** – (*E tronditür*) Asimin? (*Të gjithë shihen në sy me njëri-tjetrin.*)

**METUSHI** – (*Pas një pauze të shkurtër.*) Vazhdo, vazhdo, Tafil!

**TAFILI** – (Duke vazhduar leximin e letrës) ... dhe vepro siç kemi rënë dakord. Pra, mirupafshim, Kolë! Tani, me padurim, pres vetëm çastin kur arma ime do ta detyrojë Metushin dhe shokët që ka pranë të më jepen në duar të gjallë:

Saluti fashisti  
Gabrieli.

**PUNËTORI** – Keni shpëtuar për mrekulli, more bij! Ja kush na paska qenë edhe Asim Zagora! E kam dëgjuar shpesh këtë emër, por e pata menduar ndryshe këtë njeri!

**GJERGJI** – Asimi?! E pamundur! (Hyn tetoja e trondit) ...

**METUSHI** – Ç'ka ndodhur, teto Katinë?

**TETOJA** – Çelikun...

**METUSHI** – E arrestuan?

**MEHMETI** – E arrestuan?

**TETOJA** – Me të dalë që këtej! Kurse tani janë derdhur e po arrestojnë këdo që gjejnë nëpër rrugë.

**KARADAKU** – Shkojmë, shokë!

**METUSHI** – Secili sipas drejtimit të caktuar që më parë! (Bëhen gati të dalin, po në këtë çast hyn Asimi me revolver në dorë, i loddhur e i dërrmuar shpirtërisht. Të tjerët instinktivisht vënë dorën në brez. Por ai krahun e mban të lëshuar, pastaj revolverin me grykë poshtë e hedh përtokë. Të tjerët, të shtangur, heqin duart nga brezi. Pauzë e gjatë)

**IRENA** – (E trondit thellë) Ti këtu?!

(Asimi i heshtur e i trondit, pohon me kokë.)

**PUNËTORI** – (Me habi.) Krejt si ai që vran Kolën dhe marshall Gabrielin!

**TETOJA** – Asim, bir! Ti ... Gabrielin e Kolën? (Pret me ankth.)

**ASIMI** – (Flet me vështirësi.) Gjaku i tyre s'e lan dot njollën që Asim Zagora i vuri vetes, teto Katinë!

**PUNËTORI** (Si me vete.) Asim Zagora?! Krejt si ai zë që i foli marshall Gabrielit!

**TETOJA** – Po kapitenin Anxhelo, Asim?

**ASIMI** — As ai gjak s'e lan dot atë njollë, teto Katinë!

**IRENA** — (*Si me vete.*) Kapitenin Anxhelo?!

**TETOJA** — (*E mallëngjyer.*) Bir! Ma thoshte zemra që ti... — (*Derdhet ta përqafojë.*)

**MEHMETI** — Edhe unë e kisha të fortë atë besim!...

**GJERGJI** — S'do ta harroj kurrë këtë takim të çuditshëm!

**TETOJÄ** — (*Duke e prekur, i laget dora.*) Gjak! Po ti je i plagosur, bir! (*I hap xhaketën. Në anën e djathë të kraherorit shquan një vuratë e kuqe. Shokët e vënë re.*)

**ASIMI** — As edhe ajo plagë teto Katinë, s'e lan dot njollën që Asim Zagora i vuri vetes! Vetëm më vjen keq që Çeliku sonte nuk ndodhet këtu. Ai me të tjerët kishin të drejtë. Erdha, sipas fjalës, të më gjykojnë!...

(*I merren mendtë nga gjaku që i ka rrjedhur. Gati përtë rënë.)*

**IRENA** — Asim!

**METUSHI** — Asim! (*Derdhet bashkë me Irenën dhe s'e lënë të bjerë. Irena duke e mbështetur në gjoks e vendos midis krahëve.*)

**ASIMI** — (*Duke hapur sytë, mundohet t'iu buzëqeshë. Me zë të shuar.*) Irenë! Metush! Shokë... (*Por befas sytë i myllen e koka i varet.*)

**MEHMETI** — (*Me pikëllim, duke i vënë dorën në zemër*) Mbaroi! (*Pauzë e gjatë.*)

**PUNËTORI** — Edhe kështu duket sikur do të fluturojë! (*Heq kasketën dhe ul kryet para të vdekurit.*)

**METUSHI** — (*I trondit.*) Shqipet edhe mund të rrëzohen ngandonjëherë, po vdekjen gjithnjë e bëjnë mbi maja...

**TETOJA** — (*Me ton burrëror.*) Bir! Bir!

**METUSHI** — Shokë! Le të heshtim një çast për atë që e deshëm aq shumë. (*Të gjithë nderojnë me grushtin lart, përveç Irenës që e ka në krahë Asimin. Ndërkohë skena dalngadalë pothuajse errësohet. Nga mikrofoni, i ngadalë, i rëndë e solemn fillon të dëgjohet zëri i Thanas Vërrisë:*)

**ZËRI** — Kështu ndodhi kjo histori e dhimbshme me Asim Zagorën dhe të tjerët, që i patë në këtë sallë. Po historja e të mashtruarve në radhët e proletariatit botëror vazh-

don e do të vazhdojë të përsëritet gjersa në botë të ketë imperialistë e revisionistë, gjersa mbi rruzull të ketë kapitalistë dhe shërbëtorë të borgjezisë kapitaliste, siç janë trockistët dhe renegatët e të gjitha ngjyrave që nga Nikita Hrushovët e Leonid Brezhnevët gjer tek Berzhetë e Berlinguerët me shokë.

Dhe në këtë rrjedhë të zjarrtë të historisë numri i të zhgënjerëve gjithnjë rritet. Ata, si dikur Asim Zagorët e Teno Gorenët po i zgjojnë e do t'i zgjojnë plotësisht ortegjet e kuq të milionave që po ngrihen e po vërshojnë nga do nëpër botë nën tingujt e fuqishëm të Internacionales. (*Nga prapaskena, lehtë nisin të dëgjohen tingujt e Internacionales.*) Ja, unë i ndiej ata tinguj! Unë e ndiej atë hap të tyre që afrohet! Është tufani që një ditë do ta zhbijë nga themellet borgjezinë dhe imperializmin gjakatar, që një ditë do ta zhbijë për jetë të jetëve revisionizmin renegat. (*Skena përsëri fillon të ndriçohet. Gjendja e mëparshme. Duke shoqëruar tingujt që vijnë nga prapaskena nisin të këndojnë edhe ata që janë në skenë, me përjashtim të Asimit që akoma ndodhet në krahët e Irenës. Tani tingujt e strofës së parë të Internacionales buçasin fuqishëm në sallë. Me të nisur refreni, sipari nis të mbyllët pak nga pak, po tingujt e himnit të proletariatit botëror edhe kur perdja mbyllët plotësisht vazhdojnë të buçasin me forcë.*)

- FUND -

Tirazhi 2.000 kopje

Format 78x109/32

Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re.  
Tiranë, 1977